



INDUSTRIA SHQIPTARE E MBROJTJES HYN NË NJË FAZË TË RE

Qeveria miraton pesë akte për modernizimin e industrisë shqiptare të mbrojtjes

» faqe 3



SHQIPËRIA FORCON KAPACITETET PËR PËRBALLIMIN E EMERGJENCAVE CIVILE

Në Bazën Ajrore të Farkës u prezantua gatishmëria e strukturave të mbrojtjes civile për sezonin e zjarreve. Në Bazën Ajrore të Farkës u zhvillua aktiviteti për prezantimin e kapaciteteve operacionale dhe gatishmërisë së strukturave të mbrojtjes civile për përballimin e sezonit të zjarreve, në prani të Kryeministrit Edi Rama, ministrit të Mbrojtjes Ermal Nufi, ministrit të Brendshëm Besfort Lamallari...

faqe 2



NJË LULE PËR TË RËNËT, NJË MËSIM PËR TË GJALLËT

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Kur kujtesa bëhet mision. Mësimi i Oosterbeek-ut dhe detyrimi ynë për të mos lejuar që historia shqiptare të mbulohet nga harresa. Në historinë e popujve ka ngjarje që ndryshojnë fatin e kombeve dhe ka histori të vogla që ndryshojnë mënyrën se si një shoqëri zgjedh ta kujtojë të kaluarën. Një prej tyre vjen nga Oosterbeek-u...

faqe 6



104 VJET MARRËDHËNIE DIPLOMATIKE SHQIPËRI-SHBA

Një partneritet strategjik në shërbim të mbrojtjes, sigurisë dhe orientimit euroatlantik të Shqipërisë

Një partneritet strategjik në shërbim të paqes, sigurisë dhe orientimit euroatlantik të Shqipërisë. Më 28 korrik 1922, shënohet një nga momentet më të rëndësishme në historinë diplomatike të shtetit shqiptar. Pikërisht në këtë datë, Shqipëria dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës...

faqe 9

Shqipëria forcon kapacitetet për përballimin e emergjencave civile

Në Bazën Ajrore të Farkës u prezantua gatishmëria e strukturave të mbrojtjes civile për sezonin e zjarreve

Në Bazën Ajrore të Farkës u zhvillua aktiviteti për prezantimin e kapaciteteve operacionale dhe gatishmërisë së strukturave të mbrojtjes civile për përballimin e sezonit të zjarreve, në prani të Kryeministrit **Edi Rama**, ministrit të Mbrojtjes **Ermal Nufi**, ministrit të Brendshëm **Besfort Lamallari**, ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor **Ervin Demo**, shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant **Arben Kingji**, si dhe prefektëve, kryetarëve të bashkive, drejtuesve të institucioneve dhe efektivëve të angazhuar në mbrojtjen civile.

Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes, **Ermal Nufi**, theksoi se Shqipëria është sot më e përgatitur dhe më e koordinuar se kurrë për t'u përballur me emergjencat civile, duke nënvizuar se rezultatet e deritanishme e rendisin këtë sezon ndër më të suksesshmit në menaxhimin e zjarreve.

“Sot, me krenari them se ky mund të jetë ndër vitet më të mira për sa i përket situatës së menaxhimit të zjarreve. Kjo nuk është për shkak të fatit apo rastësisë, por falë koordinimit dhe angazhimit të jashtëzakonshëm të të gjitha strukturave që menaxhojnë situatat emergjente”, - u shpreh ministri Nufi. Duke iu referuar përvojës së vitit 2025, ministri kujtoi se sezoni i kaluar përbënte një sfidë të rëndësishme për strukturat e mbrojtjes civile, për shkak të intensitetit të lartë dhe përhapjes së zjarreve në një pjesë të madhe të territorit të vendit. Ai theksoi se përvoja e fituar ka shërbyer për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe përmirësimin e kapaciteteve operacionale.

“Dëshmia më e mirë është se kur institucionet bashkëpunojnë dhe kur profesionalizmi e përgjegjësia vihen mbi çdo interes tjetër, ne jemi në gjendje t'u përgjigjemi me sukses edhe sfidave më të vështira. Mirënjohje shumë të sinqertë për secilin efektiv dhe punonjës që kontribuon në këtë sektor”, - deklaroi ministri i Mbrojtjes.

Një pjesë e rëndësishme e fjalës së ministrit Nufi iu kushtua forcimit të kapaciteteve të pushtetit vendor në fushën e mbrojtjes civile. Ai bëri të ditur se financimi për këtë sektor është rritur ndjeshëm, nga rreth **800 milionë lekë gjatë vitit 2025 në mbi 1 miliard lekë të planifikuara për vitin 2026**, duke e konsideruar këtë një investim të drejtpërdrejtë për rritjen e aftësive të bashkive dhe strukturave vendore në menaxhimin e emergjencave.

Në përmbyllje, ministri i Mbrojtjes shprehu mirënjohjen për të gjitha strukturat e përfshira në përballimin e



emergjencave civile, duke vlerësuar punën e zjarrfikësve, prefektëve, kryetarëve të bashkive, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Forcave të Armatosura dhe të gjithë efektivëve që çdo ditë angazhohen në terren dhe nga ajri për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve.



Aktiviteti në Bazën Ajrore të Farkës shërbeu gjithashtu për të demonstruar kapacitetet operacionale dhe nivelin e gatishmërisë së strukturave të mbrojtjes civile, duke konfirmuar rëndësinë e koordinimit ndërinstitutional dhe të reagimit të shpejtë në mbrojtje të jetës, pronës dhe mjedisit.



Ratifikohet Marrëveshja e Huasë mes Shqipërisë dhe SHBA-së, ministri Ermal Nufi: Një investim strategjik për sigurinë kombëtare dhe modernizimin e Forcave të Armatosura

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ratifikoi Marrëveshjen e Huasë direkte ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, një zhvillim që ministri i Mbrojtjes **Ermal Nufi** e cilësoi si një moment historik dhe një dëshmi konkrete të mbështetjes strategjike amerikane për vendin tonë.

Përmes një reagimi publik, ministri Nufi theksoi se kjo marrëveshje përfaqëson aktin më domethënës të mbështetjes amerikane ndaj Shqipërisë që nga rivendosja e marrëdhënieve diplomatike mes dy vendeve në vitin 1990 dhe pas anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, duke e konsideruar atë një investim me rëndësi të veçantë për të ardhmen e sigurisë dhe mbrojtjes së vendit.

Sipas ministrit, marrëveshja shkon përtej dimensionit financiar dhe përbën një investim strategjik në funksion të rritjes së kapaciteteve mbrojtëse të Shqipërisë, duke mbështetur objektivat e Aleancës në kuadër të konceptit **NATO 3.0** dhe angazhimin e vendit si një aleat i besueshëm dhe i përkushtuar.

“Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje është një ngjarje historike dhe një dëshmi konkrete e mbështetjes strategjike të Shteteve të Bashkuara për Shqipërinë. Ky nuk është thjesht një instrument financiar, por një investim strategjik për sigurinë kombëtare, për modernizimin e Forcave të Armatosura dhe për forcimin e partneritetit tonë me aleatin më të rëndësishëm në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes”, - u shpreh ministri Nufi.

Ai nënvizoi se përfitimet e kësaj marrëveshjeje do të ndikojnë drejtpërdrejt në përsheptimin e procesit të modernizimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, duke rritur aftësitë operacionale, nivelin e gatishmërisë dhe ndërveprueshmërinë me forcat e



vendeve aleate. Njëkohësisht, marrëveshja konsiderohet si një tjetër hap i rëndësishëm në forcimin e partneritetit strategjik ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, marrëdhënie që prej dekadash mbështetet mbi vlera të përbashkëta, bashkëpunim të ngushtë dhe angazhim për sigurinë kolektive.

Ministri i Mbrojtjes theksoi se mbështetja e SHBA-së ka qenë vendimtare në transformimin dhe zhvillimin e Forcave të Armatosura shqiptare, ndërsa ratifikimi i kësaj marrëveshjeje hap një fazë të re investimesh në sektorin e

mbrojtjes, duke krijuar mundësi për rritjen e kapaciteteve strategjike dhe përmbylljen e objektivave të vendit në kuadër të NATO-s.

Ky zhvillim vlerësohet si një moment me rëndësi të veçantë për sigurinë kombëtare, modernizimin e mbrojtjes dhe konsolidimin e mëtejshëm të marrëdhënieve strategjike ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke konfirmuar edhe një herë partneritetin e qëndrueshëm mes dy vendeve në shërbim të paqes, stabilitetit dhe sigurisë rajonale e euroatlantike.

Në mbledhjen e fundit të Këshillit të Ministrave për këtë sezon u miratuan pesë akte të rëndësishme që lidhen me sektorin e mbrojtjes, duke shënuar një tjetër hap në zbatimin e politikave të qeverisë për forcimin e kapaciteteve të sigurisë kombëtare dhe zhvillimin e industrisë shqiptare të mbrojtjes. Lajmi u bë i ditur nga ministri i Mbrojtjes, **Ermal Nufi**, i cili e cilësoi paketën e vendimeve si një ndër zhvillimet më të rëndësishme të muajve të fundit për sektorin.

Në qendër të këtyre vendimeve qëndron ndryshimi i ligjit **“Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)”**, një nismë që synon krijimin e një mjedisi më konkurrues për kompanitë që operojnë në industrinë e mbrojtjes dhe për ndërmarrjet e përbashkëta që do të investojnë në Shqipëri.

Sipas ministrit Nufi, ky ndryshim nuk është thjesht një lehtësi fiskale, por një instrument strategjik që synon të nxisë investimet, të përshpejtojë modernizimin teknologjik të industrisë së mbrojtjes dhe të rrisë aftësinë prodhuese të vendit në një sektor me rëndësi jetike për sigurinë kombëtare.

“Në mbledhjen e fundit të Këshillit të Ministrave për këtë sezon u miratuan pesë akte që lidhen me Ministrinë e Mbrojtjes. Një prej vendimeve më të rëndësishme është ndryshimi i ligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), me qëllim lehtësimin e procedurave për kompanitë dhe ndërmarrjet e përbashkëta që operojnë në industrinë e mbrojtjes”.

Ministri theksoi se zhvillimet e viteve të fundit në mjedisin ndërkombëtar të sigurisë kanë treguar se vendet anëtare të NATO-s duhet të investojnë më shumë jo vetëm në aftësitë operacionale të forcave të tyre të armatosura, por edhe në ngritjen e një industrie të qëndrueshme të mbrojtjes, e aftë të prodhojë dhe të furnizojë në kohë pajisjet dhe sistemet e nevojshme.

Në këtë kuadër, sipas tij, Shqipëria po ndërmerr hapa konkretë për të ndërtuar një industri moderne të mbrojtjes, e cila të mbështetet në teknologji bashkëkohore, partneritete ndërkombëtare dhe investime afatgjata.

“Ky ndryshim do të krijojë kushte më të favorshme për investimet dhe për sjelljen në Shqipëri të teknologjive më të avancuara në këtë sektor, duke nxitur zhvillimin e fabrikave dhe kompanive që prodhojnë mjete dhe pajisje ushtarake”.

Industria e mbrojtjes, prioritet kombëtar

Ministri Nufi nënvizoi se zhvillimi i industrisë së mbrojtjes nuk duhet parë vetëm si një politikë ekonomike, por si një domosdoshmëri strategjike në funksion të sigurisë kombëtare.

Sipas tij, investimet në këtë sektor krijojnë mundësi për rritjen e pavarësisë në furnizimin me pajisje ushtarake, zvogëlojnë varësinë nga tregjet ndërkombëtare dhe garantojnë reagim më të shpejtë në situata emergjente apo krizash.

Ai vlerësoi se ndryshimet fiskale do të krijojnë kushte më të favorshme për kompanitë shqiptare dhe partnerët ndërkombëtarë që synojnë të investojnë në prodhimin e pajisjeve ushtarake, sistemeve teknologjike dhe logjistikës së mbrojtjes.

Në të njëjtën kohë, këto masa pritet të nxisin transferimin e teknologjisë, rritjen e standardeve të prodhimit dhe krijimin e vendeve të reja të punës me kualifikim të lartë.

Modernizimi i Forcave të Armatosura

Në deklaratën e tij, ministri i Mbrojtjes e lidhi drejtpërdrejt zhvillimin e industrisë vendase me procesin e modernizimit të Forcave të Armatosura. Ai theksoi se rritja e kapaciteteve prodhuese do të krijojë mundësi që nevojat e ushtrisë shqiptare të plotësohen më shpejt dhe me efikasitet më të lartë, duke garantuar një furnizim të qëndrueshëm me pajisje dhe mjete sipas standardeve të NATO-s.

“Lehtësimi fiskal do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe do të garantojë furnizimin

INDUSTRIA SHQIPTARE E MBROJTJES HYN NË NJË FAZË TË RE

Qeveria miraton pesë akte për modernizimin e industrisë shqiptare të mbrojtjes



në kohë reale të Forcave të Armatosura dhe forcave të tjera të sigurisë në vend”.

Ministri vuri në dukje se zhvillimi i industrisë së mbrojtjes do të ndikojë jo vetëm në aftësitë ushtarake, por edhe në ekonominë kombëtare, duke gjeneruar investime të reja, punësim dhe rritje të eksporteve në sektorët e teknologjisë dhe prodhimit.

Partneritet me industrinë ndërkombëtare

Një element i rëndësishëm i reformës është krijimi i kushteve më të favorshme për bashkëpunimin me kompani ndërkombëtare të industrisë së mbrojtjes. Sipas ministrit, Shqipëria synon të shndërrohet në një partner të besueshëm për investitorët strategjikë, duke ofruar një kuadër ligjor dhe fiskal më konkurrues, që favorizon investimet afatgjata dhe prodhimin vendas. Në këtë mënyrë, vendi synon të përfitojë nga transferimi i teknologjive moderne, rritja e ekspertizës profesionale dhe zhvillimi i kapaciteteve industriale në përputhje me standardet euroatlantike.

Në funksion të objektivave të NATO-s

Ministri Nufi theksoi se këto zhvillime janë në përputhje

me angazhimet që Shqipëria ka marrë si vend anëtar i NATO-s dhe me objektivat e Aleancës për forcimin e bazës industriale të mbrojtjes. Sipas tij, mjedisi aktual i sigurisë kërkon investime të qëndrueshme në mbrojtje, aftësi prodhuese dhe teknologji të avancuara, ndërsa industria e mbrojtjes përbën një element kyç për garantimin e sigurisë kombëtare dhe kolektive.

Një vizion për të ardhmen

Në përfundim, ministri i Mbrojtjes theksoi se pesë aktet e miratuara nga Këshilli i Ministrave përfaqësojnë një paketë reformash që synojnë të krijojnë një sektor të mbrojtjes më modern, më konkurrues dhe më të aftë për t’iu përgjigjur sfidave të kohës. Ai nënvizoi se investimet në industrinë e mbrojtjes janë investime në sigurinë e vendit, në zhvillimin ekonomik dhe në të ardhmen e Forcave të Armatosura. Paketa e re e masave pritet të krijojë një klimë më të favorshme për investitorët, të përshpejtojë modernizimin e industrisë ushtarake shqiptare dhe të forcojë kapacitetet prodhuese në funksion të mbështetjes së Forcave të Armatosura dhe strukturave të tjera të sigurisë, duke konsoliduar më tej rolin e Shqipërisë si një aleat aktiv dhe i besueshëm në NATO.

Rriten kapacitetet operacionale për garantimin e sigurisë së lundrimit

Shërbimi Hidrografik Shqiptar zhvilloi një stërvitje detare në **Gjirin e Durrësit**, me pjesëmarrjen e anijeve **A-81** dhe **A-82**, në kuadër të programit të përgatitjes dhe rritjes së gatishmërisë operacionale të ekuipazheve.

Stërvitja u përqendrua në zhvillimin e aftësive praktike për kryerjen e operacioneve të kontrollit, mirëmbajtjes dhe funksionimit të sistemit të sinjalistikës detare, një komponent thelbësor për garantimin e sigurisë së lundrimit në hapësirën detare të Republikës së Shqipërisë.

Gjatë aktivitetit, ekuipazhet realizuan procedurat standarde të inspektimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të sinjalistikës detare, duke testuar njëkohësisht koordinimin, reagimin dhe efektivitetin operacional në përmbytjen e detyrave të përditshme në det.

Stërvitja synoi gjithashtu forcimin e kapaciteteve profesionale të personelit dhe rritjen e gatishmërisë për përballimin me efikasitet të çdo situatë që lidhet me funksionimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës hidrolundrimore.

Shërbimi Hidrografik Shqiptar vijon të mbetet i angazhuar në zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve operacionale dhe në garantimin e sigurisë së lundrimit, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, duke kontribuar në sigurinë e trafikut detar dhe mbështetjen e misioneve të Forcës Detare në ujërat territoriale të Republikës së Shqipërisë.



Shërbimi Hidrografik Shqiptar zhvillon stërvitje detare në Gjirin e Durrësit



Përfundojnë me sukses kurset elitare “Komando” dhe “Operator i Zbulimit”

Ministri Ermal Nufi: Forcat Speciale janë në vijën e parë të transformimit të Forcave të Armatosura

Në Regjimentin e Operacioneve Speciale (ROS), në Zall Herr, u zhvillua ceremonia e përfundimit të kursit “**Komando**” dhe kursit “**Operator i Zbulimit**”, dy prej programeve më elitare dhe më sfiduese të përgatitjes ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Në aktivitetet morën pjesë ministri i Mbrojtjes, **Ermal Nufi**, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant **Arben Kingji**, drejtues të lartë ushtarakë, efektivë të Regjimentit të Operacioneve Speciale, familjarë të kursantëve dhe të ftuar.

Ceremonia nisi me demonstrime dinamike operacionale, ku kursantët dhe efektivët e ROS shfaqën aftësitë e përfituara gjatë muajve të stërvitjes intensive. Të pranishmit ndoqën skenarë të mbijetesës në terren, ndërtimit të pikave të vrojtimit, operacioneve të zbulimit dhe mbikëqyrjes së objektivave me vlerë të lartë, ndërhyrjes në objekte, përdorimit të sistemeve ajrore pa pilot, tërheqjes në fushën e luftimit, si edhe demonstrime të teknikave të luftimit trup me trup dhe përdorimit të armatimit individual.

Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes, **Ermal Nufi**, përgëzoi kursantët për përfundimin me sukses të dy kurseve, duke e cilësuar këtë moment si rezultat të një procesi të vështirë përgatitjeje dhe si një dëshmi të karakterit, disiplinës dhe profesionalizmit të tyre.

“Për muaj me radhë jeni përballur me sfida fizike, psikologjike dhe profesionale, duke dëshmuar se Forcat Speciale ndërtohen mbi disiplinën, vendosmërinë dhe besimin te skuadra. Sot fitoni jo vetëm një kualifikim të merituar, por mbi të gjitha besimin për të qenë pjesë e elitës së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, - u shpreh ministri Nufi.

Duke u ndalur te zhvillimet e mjedisit bashkëkohor të sigurisë, ministri theksoi se teknologjia, intelijenca artificiale, sistemet pa pilot dhe kërcënimet hibride po ndryshojnë mënyrën e zhvillimit të konflikteve, ndërsa aftësia për t’u përshtatur mbetet elementi kryesor i suksesit të një force moderne.

Sipas tij, Regjimenti i Operacioneve Speciale mishëron pikërisht këto cilësi dhe përfaqëson nivelin më të lartë të aftësive operacionale të Forcave të Armatosura.

“ROS mishëron pikërisht këto cilësi dhe përfaqëson majën e aftësive operacionale të Forcave të Armatosura. Shqipëria është pjesë aktive e transformimit të NATO 3.0 dhe po investon seriozisht për të ndërtuar Forca të Armatosura moderne, të afta të kontribuojnë me dinjitet në mbrojtjen kolektive të Aleancës”, - deklaroi ministri Nufi.

Ministri vuri në dukje se rritja e buxhetit të mbrojtjes në **2.6 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto** përfaqëson një angazhim konkret të qeverisë shqiptare për forcimin e mbrojtjes kombëtare, modernizimin e kapaciteteve dhe rritjen e gatishmërisë operacionale.



Ai nënvizoi se investimet në teknologji, infrastrukturë dhe pajisje moderne duhet të shoqërohen me investimin më të rëndësishëm – atë të burimeve njerëzore.

“Ne duam të ndërtojmë Forca të Armatosura më moderne, më të afta dhe plotësisht të ndërveprueshme me aleatët tanë. Forca të pajisura me teknologjinë më bashkëkohore, me infrastrukturë moderne dhe, mbi të gjitha, me personel të trajnuar sipas standardeve më të larta të NATO-s. Dhe në qendër të këtij transformimi janë njerëzit”, - theksoi ministri i Mbrojtjes.

Një nga momentet më emocionuese të ceremonisë ishte **betimi i kursantëve komando**, i shoqëruar me vendosjen simbolike të **beretave blu**, simbol i përkatësisë në radhët e Forcave Speciale. Në vijim u zhvillua ceremonia e ndarjes së certifikatave për kursantët e dalluar, të cilat u dorëzuan nga ministri i Mbrojtjes, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe komandanti i Regjimentit të Operacioneve Speciale.

Pas përfundimit të aktivitetit, ministri **Ermal Nufi** dhe gjenerallejtënant **Arben Kingji** zhvilluan një vizitë në shtabin e Regjimentit të Operacioneve Speciale, ku u njohën me ecurinë e njësive, misionet, kapacitetet aktuale dhe prioritetet e zhvillimit të saj në kuadër të transformimit të vazhdueshëm të Forcave të Armatosura.

Ceremonia në Zall Herr konfirmoi edhe një herë rëndësinë që Forcat e Armatosura i kushtojnë përgatitjes së personelit të Forcave Speciale, si një komponent kyç për përballimin e sfidave të sigurisë, rritjen e ndërveprueshmërisë me aleatët dhe përmbushjen me sukses të misioneve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Komandanti i Forcës Ajrore pret në takim përshëndetës Atasheun e Mbrojtjes të Republikës së Turqisë

Vlerësohet bashkëpunimi në zhvillimin e kapaciteteve të Forcës Ajrore dhe Detashmentit UAV

Komandanti i Forcës Ajrore, **gjeneral brigade Edmond Voci**, zhvilloi një takim përshëndetës me Atasheun e Mbrojtjes të Republikës së Turqisë në Shqipëri, **kolonel Tolga Kip**, me rastin e përfundimit të mandatit të tij diplomatik në vendin tonë.

Takimi u përqendrua në vlerësimin e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet Forcës Ajrore të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë, me theks të veçantë te mbështetja e dhënë për zhvillimin e kapaciteteve operacionale dhe bashkëpunimin në kuadër të **Detashmentit të Mjeteve Ajrore Pa Pilot (UAV)**.

Gjatë bisedës, të dy bashkëbiseduesit evidentuan nivelin e lartë të partneritetit ushtarak ndërmjet dy vendeve aleate në NATO, duke vlerësuar kontributin e vazhdueshëm të palës turke në modernizimin e Forcës Ajrore, përgatitjen profesionale të personelit të mjeteve ajrore pa pilot dhe shkëmbimin e eksperiencave në fusha me interes të përbashkët.

Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade **Edmond Voci**, shprehu mirënjohjen për kontributin dhe angazhimin e kolonel **Tolga Kip** gjatë ushtrimit të detyrës së tij në



Shqipëri, duke theksuar rolin e rëndësishëm që ai ka luajtur në forcimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet forcave ajrore të dy vendeve.

Nga ana e tij, Atasheu i Mbrojtjes i Republikës së Turqisë vlerësoi marrëdhëniet shumë të mira të bashkëpunimit me Forcën Ajrore dhe institucionet e mbrojtjes shqiptare, duke shprehur bindjen se partneriteti strategjik ndërmjet Shqipërisë dhe Turqisë do të vijojë të zgjerohet edhe në të ardhmen, në funksion të rritjes së kapaciteteve ushtarake dhe forcimit të sigurisë kolektive në kuadër të Aleancës.

Takimi u zhvillua në frymën e miqësisë dhe bashkëpunimit të ndërsjellë, duke konfirmuar edhe një herë marrëdhëniet e konsoliduara ndërmjet Forcës Ajrore të Republikës së Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, të ndërtuara mbi besimin reciprok, profesionalizmin dhe angazhimin e përbashkët për zhvillimin e kapaciteteve mbrojtëse.

Me ceremoninë solemne të **Betimit Ushtarak**, ushtarët e rinj profesionistë hodhën hapin e parë në rrugëtimin e tyre në radhët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, duke marrë mbi vete përgjegjësinë për t'i shërbyer vendit me besnikëri, disiplinë dhe profesionalizëm.

Në këtë moment të rëndësishëm të jetës së tyre ushtarake, **shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji**, u uroi mirëseardhjen ushtarëve të rinj, duke e cilësuar Betimin Ushtarak si themelin mbi të cilin ndërtohet karriera dhe identiteti i çdo ushtaraku.

“Jam besimplotë se, me përkushtimin, disiplinën dhe vlerat që do t’ju udhëheqin, do të ndërtoni një karrierë të suksesshme, të mbështetur mbi nderin, integritetin dhe devotshmërinë në shërbim të Atdheut”, - u shpreh gjenerallejtënant Kingji.

Ceremonia e betimit shënon përfundimin e fazës së parë të formimit ushtarak dhe fillimin e një rrugëtimi profesional në shërbim të mbrojtjes së sovranitetit dhe sigurisë së Republikës së Shqipërisë. Përmes këtij akti solemni, ushtarët e rinj angazhohen të respektojnë Kushtetutën dhe ligjet e vendit, të zbatojnë me përgjegjësi detyrat ushtarake dhe të mbrojnë interesat kombëtare në çdo rrethanë.

Forcat e Armatosura vijnë t'i kushtojnë rëndësi të veçantë përgatitjes dhe edukimit të brezit të ri të ushtarakëve, duke investuar në formimin profesional, disiplinën dhe kultivimin e vlerave që përbëjnë themelin e institucionit ushtarak.

Betimi Ushtarak mbetet një nga momentet më domethënëse në jetën e çdo ushtaraku, duke simbolizuar nisjen e një misioni të bazuar në përgjegjësi, sakrificë dhe shërbim me nder ndaj Atdheut.



Ushtarët e rinj profesionistë bëjnë Betimin Ushtarak, Gjenerallejtënant Arben Kingji: Shërbejini Atdheut me nder, integritet dhe përkushtim



Toger Donald Vesel Hoxha shpallet “Qytetar Nderi” (pas vdekjes)

Nderim për pilotin që ra në krye të detyrës në shërbim të Atdheut

Në një ceremoni përkujtimore të organizuar nga Bashkia Dimal, në Poshnje, u nderua kujtimi i Toger Donald Vesel Hoxhës, pilotit të Forcës Ajrore të Republikës së Shqipërisë, i cili humbi jetën në krye të detyrës gjatë kryerjes së misionit në shërbim të vendit.

Në shenjë mirënjohjeje për kontributin dhe sakrificën e tij, Këshilli Bashkiak i Dimalit i akordoi Toger Donald Vesel Hoxhës titullin “Qytetar Nderi” (pas vdekjes).

Në motivacionin e këtij vlerësimi theksohet se titulli jepet: “Për sakrificën e lartë dhe rënien në krye të detyrës në shërbim të Atdheut, si pilot i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë; për përkushtimin, profesionalizmin dhe guximin e treguar gjatë shërbimit ushtarak, si dhe për shembullin e lartë të përgjegjësisë, nderit dhe devotshmërisë që la si trashëgimi për komunitetin dhe brezat e rinj”.

Ceremonia mbledhi përfaqësues të pushtetit vendor, familjarë, qytetarë, kolegë dhe ushtarakë, të cilët përkujtuan me respekt figurën e pilotit të ri, duke vlerësuar kontributin e tij në radhët e Forcës Ajrore dhe përkushtimin e treguar gjatë gjithë shërbimit.

Jeta dhe sakrifica e Toger Donald Vesel Hoxhës përfaqësojnë vlerat më të larta të profesionit ushtarak – përgjegjësinë, guximin dhe gatishmërinë për të përmbushur detyrën deri në flizimin më të madh. Ai mbetet një simbol i përkushtimit ndaj misionit dhe i besnikërisë ndaj betimit ushtarak.

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë do ta kujtojnë gjithmonë Toger Donald Vesel Hoxhën si një pilot profesionist dhe një ushtarak shembullor, ndërsa vepra dhe kujtimi i tij do të vijojnë të frymëzojnë brezat e rinj që zgjedhin të veshin uniformën dhe t'i shërbejnë Atdheut me nder, integritet dhe devotshmëri.



Një lule për të rënë, një mësim për të gjallët



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve



Forcat e Armatosura, ruajtëse të traditës dhe kujtesës

Në çdo ushtri moderne, tradita nuk është nostalgji. Ajo është pjesë e identitetit profesional. Edhe Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë mbajnë mbi supe trashëgiminë e brezave që kanë shërbyer me përkushtim ndaj atdheut.

Çdo ceremoni ushtarake, çdo betim, çdo nderim ndaj flamurit dhe çdo homazh për të rënë nuk është një formalitet protokollar. Është një mënyrë për t'u kujtuar ushtarakëve se ata janë vazhdim i një historie më të madhe se vetja. Pikërisht për këtë arsye, ruajtja e kujtesës historike duhet të jetë pjesë e kulturës sonë kombëtare. Jo për të jetuar me të kaluarën. Por për të ndërtuar të ardhmen mbi themele të forta.

Mësimi që vjen nga një qytet i vogël

Oosterbeek-u nuk është bërë i njohur vetëm për një betejë.

Është bërë i njohur sepse u tregoi botës se kujtesa nuk mbahet gjallë vetëm nga institucionet. Ajo mbahet gjallë nga qytetarët. Nga mësuesit. Nga prindërit.

Nga fëmijët.

Ndoshta edhe Shqipëria duhet të mendojë më shumë për mënyrat se si brezat e rinj mund të lidhen drejtpërdrejt me historinë e vendit të tyre, përmes vizitave të organizuara në muze dhe memoriale, përmes njohjes së historive të ushtarakëve shqiptarë, përmes projekteve edukative që i bëjnë të rinjtë pjesëmarrës aktivë në ruajtjen e kujtesës. Sepse historia nuk ruhet vetëm duke e treguar. Historia ruhet duke e jetuar.

Një amanet për brezat

Tetëdhjetë vjet më parë, disa djem të rinj zbritën nga qielli mbi një tokë të huaj për të mbrojtur lirinë. Sot, fëmijët e Oosterbeek-ut vazhdojnë t'u çojnë lule.

Nuk është thjesht një gjest mirësjelljeje. Është një premtim. Premtimi se sakrifica nuk do të harrohet. Edhe ne kemi nevojë për këtë premtim. Sepse kombet nuk bëhen të mëdha vetëm nga fitoret që arrijnë. Ato bëhen të mëdha nga mënyra se si kujtojnë ata që sakrifikuan për to. Në fund të fundit, historia nuk është vetëm ajo që ka ndodhur. Historia është ajo që zgjedhim të mos harrojmë. Dhe kur një brez ua mëson këtë brezave që vijnë pas, kujtesa nuk mbetet më vetëm pjesë e së kaluarës. Ajo bëhet mision.

Një mision që nuk i takon vetëm ushtarakëve, historianëve apo institucioneve.

Është misioni i çdo qytetari që beson se liria, identiteti dhe dinjiteti i një kombi mbrohen jo vetëm me armë, por edhe me kujtesë.

Shqipëria dhe sfida e kujtesës Edhe historia shqiptare është ndërtuar mbi sakrifica

Nga luftërat për mbijetesën e kombit, te shpallja e Pavarësisë, nga rezistenca kundër pushtuesve, te mbrojtja e kufijve dhe kontributi i Forcave të Armatosura në misionet ndërkombëtare të NATO-s, historia jonë ka emra që meritojnë të kujtohen jo vetëm në përvjetorë, por në ndërgjegjen e çdo qytetari. Në të gjithë vendin gjenden memorialë, lapidarë, muze dhe varreza dëshmorësh. Çdo gur përfaqëson një histori. Çdo emër përfaqëson një familje. Çdo monument është një dëshmi e çmimit që është paguar për lirinë, sovranitetin dhe dinjitetin e Shqipërisë. Por pyetja që duhet t'i bëjmë vetes është e thjeshtë: A mjafton ekzistenca e tyre për ta mbajtur gjallë kujtesën?

Përgjigjja është jo. Sepse historia nuk jeton te guri. Ajo jeton te njeriu. Jeton te mësuesi që e shpjegon. Jeton te prindi që e rrëfen. Jeton te ushtaraku që e nderon. Jeton te i riu që e kupton.

Brezi që nuk njeh historinë, nuk mund ta mbrojë të ardhmen

Shpesh dëgjojmë të flitet për edukimin patriotik të të rinjve. Por patriotizmi nuk ndërtohet me slogane. Ai ndërtohet me dije. Me respekt. Me kujtesë. Një i ri që njeh historinë e vendit të tij nuk është thjesht më i informuar. Ai është më i ndërgjegjshëm për përgjegjësitë që ka si qytetar.

Ai kupton se liria nuk është diçka e vetëkuptueshme.

Ai kupton se flamuri nuk është vetëm simbol.

Ai kupton se uniforma ushtarake nuk është vetëm një profesion, por një betim.

Kjo është arsyeja pse historia duhet të jetë pjesë e edukimit të përditshëm dhe jo vetëm e kalendarit të festave kombëtare.

Kur kujtesa bëhet mision

Mësimi i Oosterbeek-ut dhe detyrimi ynë për të mos lejuar që historia shqiptare të mbulohet nga harresa

Në historinë e popujve ka ngjarje që ndryshojnë fatin e kombeve dhe ka histori të vogla që ndryshojnë mënyrën se si një shoqëri zgjedh ta kujtojë të kaluarën.

Një prej tyre vjen nga Oosterbeek-u, një qytet i vogël në Holandë, ku prej tetëdhjetë vitesh fëmijët janë bërë rojet më besnike të kujtesës.

Në varrezat ushtarake të Oosterbeek-ut prehen 1.759 ushtarë të rënë gjatë Betejës së Arnhemit në shtator të vitit 1944. Ata ishin britanikë, polakë, kanadezë dhe ushtarë të tjerë aleatë që zbritën nga qielli në kuadër të Operacionit “Market Garden”, një nga operacionet më të guximshme të Luftës së Dytë Botërore. Shumë prej tyre ishin vetëm tetëmbëdhjetë apo njëzet vjeç. Ata nuk luftuan për tokën e tyre. Luftuan për lirinë e një populli tjetër, duke ditur se mund të murrë në shtëpi.

Dhe vërtet nuk u kthyen. Por nuk mbetën vetëm. Kur lufta mbaroi, banorët e Oosterbeek-ut nuk menduan se mjaftonin monumentet, pllakat përkujtimore apo ceremonitë zyrtare. Ata kuptuan se kujtesa nuk trashëgohet vetvetiu. Ajo duhet kultivuar.

Kështu lindi një traditë e pazakontë, por jashtëzakonisht domethënëse. Çdo nxënës i shkollës “adopton” një varr.



Ai mëson emrin e ushtarit, vendin nga vinte, moshën, historinë e jetës së tij dhe mënyrën se si ra në fushën e betejës. Çdo vit, ai vendos lule, kujdeset për varrin dhe merr pjesë në ceremonitë e përkujtimit. Tetëdhjetë vjet më vonë, kjo traditë vazhdon. Në heshtjen e asaj varreze nuk dëgjohen vetëm hapat e fëmijëve.

Dëgjohet zëri i një shoqërie që u thotë brezave të rinj: **Liria nuk fillon me ne dhe nuk mbaron me ne. Ajo është një amanet.**

Kujtesa nuk është e shkuara. Është e ardhmja.

Historia e Oosterbeek-ut nuk është e rëndësishme, sepse flet për një betejë të Luftës së Dytë Botërore. Rëndësia e saj qëndron te mënyra se si një komunitet vendosi të mbrojë kujtesën. Në një epokë ku gjithçka matet me

ekraneve dhe rrjeteve sociale, ata zgjedhën t'i çojnë fëmijët pranë gurëve të bardhë të varreve. Në vend që t'u tregonin vetëm data, u treguan histori. Në vend që t'u mësonin vetëm emra, u mësuan përgjegjësi. Sepse ata e dinin një të vërtetë të thjeshtë: një komb nuk fillon të humbasë kur humbet një luftë. Ai fillon të humbasë kur humbet kujtesën.

Sistemet dhe operacionet “biohibride”



KOLONEL (R) HYSNI GJERGJI
Ekspert i Inteligjencës, Koordinator i Sigurisë në AIM

Pikënisje e kësaj analize është deklarata e Ministrisë kineze të Sigurisë së Shtetit, e qershorit 2026, për përdorimin e pretenduar të “breshkave dhe peshqve spiunë” të pajisur me sensorë. Rasti vlerësohet si pretendim zyrtar me plausibilitet teknik, por pa prova publike të mjaftueshme për verifikim të pavarur. Përfundimi kryesor është se epoka e AI-së nuk e zëvendëson domosdoshmërisht kafshën; ajo e shndërron atë në një nyje të rrjetit ISR, duke rritur njëkohësisht kapacitetin e mbledhjes dhe vështirësinë e atribuimit.

Më 12 qershor 2026, Ministria e Sigurisë së Shtetit e Republikës Popullore të Kinës deklaroi se shërbime të huaja po përdornin bova zbulimi, pajisje elektronike detare, gliderë të valëve dhe kafshë të mëdha ujore të pajisura me sensorë. Sipas deklaramit, “breshkat” dhe “peshqit spiunë” mund të mbledhnin të dhëna për temperaturën, kripësinë dhe rrymat detare dhe t’i transmetonin të dhënat në kohë reale përmes satelitit pjesë e një operacioni “biohybrid”.

Ky njoftim vijoi paralajmërimet e vitit 2024 për pajisje të fshehura në sipërfaqe dhe në shtratin e detit, të përshkruara si “fenerë nënujorë” për orientimin e nëndetësve të huaja. Megjithatë, autoritetet kineze nuk bënë publike vendndodhje, aktorë përgjegjës, materiale ose prova të verifikueshme. Prandaj, deklarata duhet lexuar njëkohësisht si sinjal kundërzbulimi, komunikim strategjik dhe përshkrim i një teknologjie të mundshme, jo si provë përfundimtare e ekzistencës së sistemeve “biohybrid” në detin e Kinës.

Përdorimi i kafshëve në konflikt nuk kufizohet tashmë te transporti ose luftimi. Në periudha të ndryshme, shpendët dhe gjitarët janë përdorur si mjete komunikimi, paralajmërimi, zbulimi, fotografimi, përgjimi dhe mbledhjeje të të dhënave mjedisore. Ky shkrim analizon dhe sjell kalimin nga kafsha si “korrier biologjik”, te kafsha si platformë sensoriale dhe, më tej, te sistemi biohybrid i lidhur me algoritme të inteligjencës artificiale.

Në lashtësi dhe në Mesjetë, avantazhi kryesor i kafshëve ishte biologjik: shpejtësia, orientimi, nuhatja, dëgjimi dhe aftësia për të kaluar terrene ku njeriu ekspozohet. Burimet historike për përdorimin shumë të hershëm të pëllumbave janë të pabarabarta dhe disa rrëfime janë legjendare; megjithatë, përdorimi i zogjve shtëpiakë për transmetim lajmesh njihet në botën e lashtë dhe u zhvillua më tej në sistemet postare të periudhave të mëvonshme. Rrjetet shtetërore të korrierëve, si barid-i në botën islamë mesjetare, kombinonin transportin e mesazheve me raportimin politik dhe administrativ, duke krijuar logjikën e një rrjeti inteligjence të mbështetur te lëvizshmëria e kafshëve.

Qentë përdoreshin për ruajtje, patrullim dhe paralajmërim. Vlera e tyre nuk qëndronte te “fshehtësia”, por te aftësia për të zbuluar praninë e njerëzve, kafshëve ose rreziqeve përpara rojës njerëzore. Kjo i bën ata paraardhës funksionalë të sensorëve modernë të perimetrit që sot bëhen me AI dhe kamera shumë të ndjeshme sigurie. Megjithatë, deri në epokën industriale, përdorimi ishte kryesisht lokal, i varur nga trajneri dhe pa standardizim doktrinar. Kthesa teknologjike erdh gjatë rrethimit të Parisit në 1870-1871. Pëllumbat korrierë u kombinuan me mikro-fotografinë. Mesazhe zyrtare, private dhe gazeta, zvogëloheshin në film dhe transportoheshin në tuba të vegjël të fiksuar te pendët e zogut. Kjo ishte më shumë se kthim te një metodë e vjetër. Ishte integrimi i parë i qartë ndërmjet një platforme biologjike, miniaturizimit të të dhënave dhe një sistemi shtetëror komunikimi nën rrethim. Modeli parashikoi logjikën e sotme, ku sensori ose bartësi mund të jetë i thjeshtë, ndërsa vlera krijohet nga kompresimi, transmetimi dhe përpunimi i informacionit.

Shumë shtete zhvillojnë programe dhe kryejnë kërkime në sistemet biohibride. Në SHBA DARPA (Defence Advanced Research Projects Agency) është agjencia e projekteve të kërkimit të avancuar të mbrojtjes në Ministrinë Amerikane të Luftës, ku sistemet biohibride janë kthyer në prioritet kryesor. Termi “operacione biohibride” nuk është ende një term doktrinar i standardizuar i NATO-s, por afërsisht është planifikimi dhe përdorimi operacional i sistemeve që kombinojnë organizma ose materiale biologjike me sensorë, robotikë, komunikim dhe AI. Pra, sistemi biohybrid është mjeti, ndërsa operacioni biohybrid është mënyra se si ai përdoret për realizimin e një misioni kryesisht spiunazhi. Përparësitë kryesore të sistemeve biohibride janë ndjeshmëria shumë e lartë biologjike, përshtatja me mjedisin, fleksibiliteti dhe potencialisht konsumi i ulët energjetik. Në perspektivën e sigurisë, operacionet biohibride mund të konsiderohen si një fushë e ardhshme në ndërthurjen e ISR-it, robotikës, bioteknologjisë, AI-së dhe luftës në shumë domene(MDO).

Sistemet biohibride janë platforma që bashkojnë në një sistem të vetëm një komponent biologjik të gjallë dhe një komponent artificial si elektronikë, sensorë, mikroprocesorë,



strukturë robotike, komunikim dhe inteligjencë artificiale. Qëllimi i kërkimeve në fushën biohibride është të kombinohen ndjeshmëria, përshtatshmëria dhe efikasiteti i biologjisë me kontrollin, përpunimin e të dhënave dhe saktësinë e teknologjisë. Insekte ose organizma të tjerë të gjallë mund të mbajnë mikrosensorë, komunikim dhe elemente kontrolli. Organizmi siguron lëvizjen dhe aftësinë për të kaluar në mjedise të vështira, ndërsa pjesa artificiale siguron drejtimin dhe transmetimin e të dhënave. Baktere, qeliza ose materiale biologjike mund të kombinohen me mekanizma artificialë për monitorim mjedisor, kërkim bio-mjekësor ose operacione zbulimi ushtarake.

Në Luftën e Parë Botërore, linjat telefonike priteshin nga artileria, sinjalet mund të përgjoheshin dhe korrierët njerëzorë ishin të ekspozuar. Ushtritë krijuan shërbime të posaçme pëllumbash, procedura regjistrimi dhe kapsula mesazhesh. “Imperial War Museums” dokumenton se, pavarësisht pajisjeve të reja të komunikimit, ushtarët vazhdonin të përdornin pëllumba dhe qen korrierë kur rrjeti teknik dështonte. Pëllumbi “Cher Ami”, pjesë e Shërbimit të Pëllumbave të *Signal Corps* amerikan, u bë simbol i kësaj rezilience, ndonëse muzeu Smithsonian paralajmëron se disa hollësi të historisë së tij janë përzier me legjendën.

Qeni u institucionalizua si roje, zbulues, patrullues dhe korrier. Në Luftën e Dytë Botërore, Ushtria amerikane i ndau qentë sipas specializimit si; *scout/patrol, messenger* dhe *mine dog*. Qeni nuk ishte vetëm “mjet transporti”, por ai krijonte informacion taktik, duke sinjalizuar praninë e kundërshtarit, rrezikim ose gjurmët. Në terma modernë, ai kryente detyra të hershme të zbulimit të afërt dhe paralajmërimit, me një bashkëpunim njeri-kafshë të bazuar në trajnim, gjeiste dhe interpretim të sjelljes.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, pëllumbat mbetën kanal reserve komunikimi në avionë, anije dhe njësi të izoluar. Ata u përdorën edhe në veprimtari klandestine për dërgimin e formulave dhe marrjen e raporteve nga popullsia e territoreve të pushtuara. Rëndësia e tyre nuk ishte kapaciteti i madh i të dhënave, por rezistenca ndaj ndërprerjes elektronike. Kjo është arsyeja pse teknologjitë e vjetra nuk zhduken plotësisht. Në një mjedis ku radioja bllokohet ose komprometohet, një kanal biologjik njëdrejtimësh mund të ketë vlerë disproporcionale.

Miniaturizimi i kamerave, mikrofonave, transmetuesve dhe baterive ndryshoi marrëdhënien ndërmjet shërbimeve të inteligjencës dhe kafshëve. CIA zhvilloi një aparat të vogël fotografik që montohej në gjoks të pëllumbit dhe fotografonte në intervale gjatë kthimit në front. Avantazhi ishte fluturimi në lartësi shumë më të ulët se avionët ose satelitët dhe maskimi brenda popullsisë së zakonshme të shpendëve. Dobësia ishte kontrolli i pamjaftueshëm i itinerarit. Vetë CIA pranon se zogjtë nuk kalonin gjithmonë mbi objektivin e dëshiruar.

Projekti “Acoustic Kitty” synonte përdorimin e një maceje me mikrofon dhe transmetues për përgjim të bisedave në mjedise të hapura. Teknologjia funksionoi, por sjellja e kafshës nuk mund të kontrollohej me saktësi dhe programi u mbyll pa përdorim operacional. Po kështu, “Insectothopter”, një mjet ajror i maskuar si pilivës, nuk u bë operacional për shkak të ndjeshmërisë ndaj erës. Ndërsa këto projekte shpesh paraqiten si kuriozitete, por mësimi është serioz. Kafsha ofron maskim, energji dhe lëvizshmëri, por sjellja biologjike krijon pasiguri dhe kufizon komandimin.

Në të njëjtën periudhë u shfaqën edhe mjete plotësisht robotike të frymëzuara nga kafshët. CIA zhvilloi peshq robotikë “Charlie” dhe “Charlene” për manovrim në ujë dhe marrje mostrash, si dhe përdori forma kafshësh të ngordhura si pajisje fshehjeje për shkëmbim materialesh. Këtu ndodhi ndarja në dy degë: Përdorimi i organizmit të gjallë dhe imitimi mekanik i tij. Kjo ndarje vazhdon edhe sot ndërmjet biohibridëve dhe robotëve biomimetikë.

Mjedisi nënujor favorizon përdorimin e aftësive biologjike, sepse komunikimi radio është i kufizuar, navigimi është

kompleks dhe objektet maskohen nga sedimenti, zhurma dhe relievi. Programi i Gjitarëve Detarë, i Marinës amerikane, aktiv që nga viti 1959, përdor sot delfinë hundë-shishe dhe luanë deti për zbulimin, lokalizimin, shënimin dhe rikuperimin e objekteve në porte, zona bregdetare dhe det të hapur. Delfinët përdorin ekolokacionin natyror, ndërsa luanët e detit kanë shikim të mirë në ndriçim të ulët dhe dëgjim drejtimor nën ujë. Programi ka testuar historikisht edhe peshkaqenë, rreze, breshka deti dhe shpendë detarë, por sot mbështetet vetëm te dy speciet kryesore.

Kjo bazë faktike e bën teknikisht të besueshme idenë se kafshët ujore mund të mbajnë sensorë. Megjithatë, ekziston një dallim thelbësor ndërmjet një gjitari të trajnuar për një detyrë ushtarake dhe një breshke ose peshku të etiketuar për mbledhje pasive të të dhënave oqeanografike. Pajisje të ngjashme përdoren gjerësisht nga biologjia detare dhe kërkimi klimatik. Prandaj, një sensor mbi kafshë nuk është vetvetiu provë spiunazhi. Klasifikimi kërkon analizë të pronësisë, frekuencave të transmetimit, enkriptimit, destinacionit të të dhënave, modelit të lëvizjes dhe lidhjes me zona të ndjeshme.

Deklarata kineze ka rëndësi sepse zgjeron fushën e kundërzbulimit detar. Tashmë objekt kërcënimi nuk është vetëm nëndetësja, droni ose bova, por edhe një organizëm i pajisur me sensor komercial. Njëkohësisht, mungesa e provave publike krijon rrezik për keqinterpretim, dëmtim të projekteve shkencore dhe përdorim propagandistik. Kundërzbulimi modern ushtarak duhet të jetë teknikisht vigjilent, por metodologjikisht skeptik.

AI-ja ndryshon fenomenin në katër drejtime. Së pari, algoritmet mund të filtrojnë të dhëna të mëdha nga kamera, hidrofoni, GPS, sensorë kimikë dhe biologjikë, duke identifikuar automatikisht anomali. Së dyti, modelet e navigimit dhe të përforcimit mund të udhëzojnë platforma biohibride ose robotike në mjedise të panjohura. Së treti, përpunimi në skaj i rrjetit lejon që vetëm informacioni me vlerë të transmetohet, duke ulur energjinë dhe gjurmën elektromagnetike. Së katërti, bashkimi i të dhënave nga shumë platforma krijon “tufa” sensoriale, ku asnjë kafshë ose robot i vetëm nuk ka pamjen e plotë, por rrjeti dhe bashkëpunimi mes tyre prodhon inteligjencë të përdorshme.

Kërkimi shkencor civil ka demonstruar insekte “cyborg” me elektronikë të butë, qeliza diellore ultratë dhe kontroll pa tela, si dhe sisteme vizuale të montuara mbi insekte të gjalla. Zbatimet e deklaruara janë kërkim-shpëtimi, monitorim mjedisor dhe inspektim i zonave të rrezikshme; megjithatë, teknologjia është qartësisht me përdorim të dyfishtë. Në të ardhmen priten tri kategoria të luftëtarëve biohibridë: kafshë të trajnuara me sensorë; organizma biohybridë me ndërfaqe nervore ose muskulore; dhe robotë biomimetikë që duken e lëvizin si kafshët, por nuk përmbajnë organizëm të gjallë.

Përfitimi kryesor është maskimi në mjedis dhe shfrytëzimi i “inteligjencës së gjallë” të natyrës: navigimi, stabiliteti, nuhatja, ekolokacioni dhe përshtatja energjetike. Dobësitë janë po aq të rëndësishme si: humbja e kontrollit, sjellja e paparashikueshme, kapja fizike e platformës, manipulimi i sinjalit, prishja e të dhënave, gabimet e klasifikimit dhe vështirësia e atribuimit. Një pajisje mund të jetë kërkimore, tregtare ose ushtarake. AI-ja mund të rrisë saktësinë, por nuk e zgjidh automatikisht problemin e qëllimit dhe përgjegjësisë.

Evolucioni historik tregon një vijë të qartë, ku kafsha fillimisht transportonte informacion; më pas shqisat e saj prodhonin informacion. Sot sensorët dhe AI-ja e bëjnë pjesë të një arkitekture të shpërndarë të zbulimit. Për shtetet me vijë bregdetare dhe infrastrukturë kritike detare ku edhe Shqipëria është e përfshirë, kjo kërkon zgjerim të konceptit të sigurisë së porteve, kablllove nënujore, bazave detare dhe zonave të testimit.

Prioriteti i parë duhet të jetë krijimi i një protokolli ndërinstytucional për raportimin, rikuperimin dhe ekzaminimin e pajisjeve të pazakonta të montuara mbi kafshë ose të gjeta në det. Protokolli duhet të përfshijë strukturat e sigurisë, forcat detare, policinë kufitare, AISM, autoritetet mjedisore, universitetet dhe operatorët e telekomunikacionit. Prioriteti i dytë është krijimi i një regjistri të projekteve legjitime shkencore dhe i mekanizmave të verifikimit të shpejtë, në mënyrë që vëgjelina të mos shndërrohet në alarm të rremë dhe të bazuar në teori konspirative. Prioriteti i tretë është zhvillimi i kapaciteteve AI për zbulimin e anomalive, por me verifikim njerëzor dhe ruajtje të zinxhirit të provës.

Në planin etik dhe juridik, përdorimi i kafshëve në operacione ushtarake ngre çështje të mirëqenies, proporcionalitetit, përgjegjësisë dhe dëmtimit të ekosistemeve. Sa më shumë rritet autonomia teknologjike, aq më e nevojshme bëhet të përcaktohet se kush mban përgjegjësi për sjelljen e sistemit; operatori, programuesi, institucioni apo shteti. Përfundimisht, “breshka spiunë” nuk është një absurditet teknologjik, por as provë automatike e një komploti. Breshka dhe delfini janë simbol i një realiteti të ri ku kufiri ndërmjet natyrës, sensorit, robotit dhe agjentit të inteligjencës po bëhet gjithnjë e më i paqartë.

NANCY WAKE, “Miu i Bardhë” që sfidoi nazizmin dhe frymëzon breza grash ushtarake

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

“Lufta nuk pyet nëse je burrë apo grua. Ajo pyet
vetëm nëse ke guxim”

Kjo është ndoshta mënyra më e mirë për të përshkruar jetën e Nancy Wake, një prej grave më të jashtëzakonshme të Luftës së Dytë Botërore. Historia e saj nuk është vetëm rrëfimi i një spiuneje apo luftëtareje të Rezistencës Franceze. Është historia e një gruaje që zgjodhi të mos ishte spektatore e historisë, por ta ndryshonte atë.

Sot, kur gratë shërbejnë në ushtritë moderne në çdo specialitet ushtarak, historia e Nancy Wake mbetet një kujtesë se rruga drejt barazisë nuk u ndërtua me fjalë, por me guxim, sakrifica dhe vendime të marra në momentet më të errëta të historisë.

Kur ndërgjegjja bëhet armë

Nancy Grace Augusta Wake lindi më 30 gusht 1912, në Wellington të Zelandës së Re dhe u rrit në Australi. E re në moshë, ajo vendosi të udhëtonte drejt Evropës, ku fillimisht punoi si infermiere dhe më pas si gazetare.

Në vitet ‘30, ndërsa raportonte nga Vjena, ajo pa me sytë e saj brutalitetin e regjimit nazist kundër hebrenjve. Ishte një përvojë që do ta shndërronte përgjithmonë. Ajo e kuptoi se liria nuk ishte më një koncept politik, por një përgjegjësi personale.

Kur Gjermania pushtoi Francën në vitin 1940, Nancy nuk zgjodhi rrugën e arratisjes. Përkundrazi, iu bashkua menjëherë Rezistencës Franceze.

Fillimisht misionet e saj dukeshin të thjeshta: transport dokumentesh të falsifikuara, ndihmë për pilotët aleatë të rrëzuar, organizim rrugësh të sigurta arratisjeje. Por çdo mision ishte një sfidë mes jetës dhe vdekjes.

Gruaja që Gestapo nuk arriti ta kapte

Aftësia për të mashtuar nazistët ishte aq e jashtëzakonshme, sa Gestapo i vendosi pseudonimin “Miu i Bardhë”.

Ajo ndryshonte identitet, kalonte postblloqe gjermane me qetësi të admirueshme dhe zhdukej përpara se armiku të kuptonte praninë e saj.

Për kapjen e saj u shpall një shpërblim prej pesë milionë frangash, një shumë e jashtëzakonshme për kohën.

Megjithatë, Nancy Wake nuk u kap kurrë.

Në vitin 1943 ajo arriti të largohej drejt Britanisë së Madhe, ku u përzgjedh nga *Special Operations Executive* (SOE), shërbimi sekret britanik i krijuar posaçërisht për operacionet speciale pas vijave armike.

Aty iu nënshtrua një prej stërvitjeve më të vështira ushtarake të kohës: sabotim, përdorim eksplozivësh, komunikime sekrete, luftim trup më trup dhe hedhje me parashutë.

Në pranverën e vitit 1944, ajo u rikthye në Francë, duke u hedhur natën me parashutë për të organizuar rezistencën para zbarkimit të Aleatëve në Normandi.

Komandante e një ushtrie guerile

Në rajonin Auvergne, Nancy Wake drejtoi rreth 7.500 luftëtarë të Rezistencës Franceze.

Nën drejtimin e saj u hodhën në erë ura, hekurudha, depo municionesh dhe linja komunikimi.

Sulmet e organizuara nga grupi i saj penguan lëvizjen e forcave gjermane drejt frontit të Normandisë.

Një nga episodet më të jashtëzakonshme ishte udhëtimi me biçikletë prej më shumë se 500 kilometrash, i realizuar për vetëm 72 orë, për të rivendosur komunikimin me Londrën pasi radiot ishin shkatërruar.

Kur u pyet pas luftës për arritjen më të madhe, ajo nuk përmendi asnjë operacion luftarak. “Për mua, ishte ai udhëtim me biçikletë.”

Çmimi i lirisë

Lufta nuk kursen askënd.

Ndërsa Nancy vazhdonte misionet e saj, bashkëshorti Henri Fiocca u arrestua nga Gestapo. Ai u torturua për muaj të tërë. Nuk foli. Nuk tregoi asgjë. U ekzekutua pa tradhtuar vendndodhjen e gruas së tij. Nancy e mësoi këtë vetëm pas përfundimit të luftës. Ajo e konsideroi këtë humbjen më të madhe të jetës së saj.



Gratë që ndryshuan historinë e luftës

Historia e Nancy Wake nuk është një rast i izoluar.

Luftërat botërore ndryshuan edhe mënyrën se si shoqëria e shihte rolin e gruas. Miliona gra u bënë infermiere ushtarake, pilote, specialiste komunikimi, partizane, snajpere, komandante njësisish dhe agjente të shërbimeve sekrete.

Në Bashkimin Sovjetik, gratë pilotuan avionë bombardues dhe luftarakë.

Në Britani drejtuan sistemet kundërajrore. Në Francë organizuan rezistencën. Në Shtetet e Bashkuara shërbyen në logjistikë, inteligjencë dhe aviacion. Në shumë raste, ato kryen misione që deri atëherë konsideroheshin ekskluzivisht mashkullore. Historia provoi se profesionalizmi nuk ka gjini.



Nga Nancy Wake te gratë ushtarake të shekullit XXI

Sot, pothuajse çdo ushtri moderne mbështetet në kontributin e grave. Ato komandojnë njësi, drejtojnë avionë luftarakë, shërbejnë në forcat speciale, në misione paqeruajtëse dhe në strukturat e NATO-s. Edhe Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë pjesë e këtij realiteti. Gratë shqiptare kanë fituar me profesionalizëm vendin e tyre në të gjitha strukturat e sistemit të mbrojtjes, duke shërbyer si oficerë, nënoficerë dhe ushtare në armë e shërbime të ndryshme.

Ato kontribuojnë në operacionet ndërkombëtare, në misionet e NATO-s, në stërvitjet shumëkombëshe, në arsimin ushtarak, në logjistikë, në mjekësinë ushtarake, në inteligjencë, komunikim dhe planifikim operacional. Prania e tyre nuk është më një përjashtim. Është pjesë e normalitetit të një force moderne.

Trashëgimia e guximit

Nancy Wake u dekorua nga Britania e Madhe, Franca, Shtetet e Bashkuara, Australia dhe Zelanda e Re, duke u bërë gruaja më e dekoruar e Luftës së Dytë Botërore. Ajo ndërroi jetë në vitin 2011, në moshën 98-vjeçare. Sipas amanetit të saj, hiri u shpërnda në Verneix të Francës, aty ku kishte luftuar për lirinë.

Por trashëgimia e saj nuk matet me medalje.

Ajo jeton në çdo grua që zgjedh uniformën ushtarake, që merr përgjegjësi në mbrojtje të vendit dhe që dëshmon se leadershipi nuk përcaktohet nga gjinia, por nga karakteri.

Nancy Wake nuk luftoi vetëm kundër nazizmit.

Ajo luftoi edhe kundër paragjykitimit se gratë nuk mund të udhëhiqnin në luftë.

Sot, mijëra gra ushtarake në mbarë botën, përfshirë edhe në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, vazhdojnë ta dëshmojnë çdo ditë se guximi, profesionalizmi dhe përkushtimi nuk kanë gjini.

Në këtë kuptim, historia e “Miut të Bardhë” nuk është vetëm histori e Luftës së Dytë Botërore.

Është histori e çdo gruaje që ka zgjedhur të mbrojë lirinë, paqen dhe sigurinë, duke veshur uniformën me të njëjtin dinjitet dhe përgjegjësi si çdo ushtarak tjetër.



104 VJET MARRËDHËNIE DIPLOMATIKE SHQIPËRI-SHBA

Një partneritet strategjik në shërbim të mbrojtjes, sigurisë dhe orientimit euroatlantik të Shqipërisë

Një partneritet strategjik në shërbim të paqes, sigurisë dhe orientimit euroatlantik të Shqipërisë

Më 28 korrik 1922, shënohet një nga momentet më të rëndësishme në historinë diplomatike të shtetit shqiptar. Pikërisht në këtë datë, Shqipëria dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës vendosën për herë të parë marrëdhëniet diplomatike, duke hedhur themelet e një partneriteti që, pavarësisht sfidave historike, ka mbijetuar në kohë dhe është shndërruar në një nga shtyllat kryesore të politikës së jashtme dhe sigurisë së Shqipërisë.

Në më shumë se një shekull marrëdhëniesh, partneriteti shqiptaro-amerikan është ndërtuar mbi besimin reciprok, vlerat e demokracisë, lirisë dhe shtetit të së drejtës, duke u shtrirë në fusha të rëndësishme si mbrojtja, siguria, zhvillimi ekonomik, arsimi dhe integrimi euroatlantik.

Fillimi i një miqësie të qëndrueshme

Vendosja e marrëdhënieve diplomatike në korrik të vitit 1922 ishte një njohje e rëndësishme ndërkombëtare për shtetin shqiptar, i cili sapo kishte nisur konsolidimin e institucioneve të tij. Vetëm pak muaj më vonë, në dhjetor të po atij viti, diplomati amerikan Ulysses Grant-Smith mbërriti në Tiranë si përfaqësuesi i parë diplomatik i Shteteve të Bashkuara në Shqipëri, duke vendosur themelet e një marrëdhënieje që do të zhvillohej vazhdimisht gjatë dekadave në vijim.

Prania amerikane në Shqipëri u bë një faktor i rëndësishëm në forcimin e lidhjeve politike dhe institucionale ndërmjet dy vendeve, duke krijuar ura bashkëpunimi që do t'i rezistonin kohës dhe zhvillimeve historike.



Një histori që nuk u ndërpre në zemrat e njerëzve

Marrëdhëniet diplomatike mes dy vendeve u ndërpre gjatë regjimit komunist, duke mbetur të pezulluara për afro pesë dekada. Megjithatë, edhe gjatë kësaj periudhe, miqësia shqiptaro-amerikane nuk u shua plotësisht.

Një nga dëshmitë më domethënëse të kësaj lidhjeje është historia e vulës së Legatës Amerikane në Tiranë.

Kur Legata Amerikane u mbyll pas pushtimit të Shqipërisë në vitin 1939, Loni Adami dhe bashkëshortja e tij, Andromaqi, morën një vendim që kërkonte guxim dhe përgjegjësi të jashtëzakonshme. Ata fshehën vulën zyrtare të Legatës Amerikane, duke e ruajtur atë për më shumë se katër dekada, në një periudhë kur një veprim i tillë mund t'u kushtonte lirinë apo edhe jetën.

Pas rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike në vitin 1991, ata zbuluan vendin ku e kishin ruajtur vulën, në bodrumin e godinës së Ambasadës Amerikane në Tiranë. Sot ajo vulë përfaqëson jo vetëm një objekt historik, por edhe simbolin e një miqësie që nuk u shua as në periudhat më të vështira të historisë.

Rivendosja e marrëdhënieve dhe një epokë e re bashkëpunimi

Më 15 mars 1991, Shqipëria dhe Shtetet e Bashkuara rivendosën zyrtarisht marrëdhëniet diplomatike, duke hapur një kapitull të ri bashkëpunimi.



Në vitet që pasuan, SHBA u bë një nga partnerët më të rëndësishëm të Shqipërisë në procesin e konsolidimit të institucioneve demokratike, reformave ekonomike dhe forcimit të shtetit ligjor.

Mbështetja amerikane ka qenë vendimtare edhe në proceset e integritimit euroatlantik të vendit. Kontributi i SHBA-së në modernizimin e sektorit të mbrojtjes dhe në transformimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë ka qenë i vazhdueshëm dhe i prekshëm.

Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO në vitin 2009 shënoi një etapë të re në këtë partneritet strategjik, duke e bërë bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes edhe më të ngushtë.



Partneritet strategjik në mbrojtje dhe siguri

Marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve kanë marrë një dimension të ri veçanërisht në fushën e mbrojtjes.

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcat e Armatosura të Shteteve të Bashkuara zhvillojnë prej vitesh një bashkëpunim të gjerë në stërvitje, edukim ushtarak, modernizim të kapaciteteve mbrojtëse, mbështetje logjistike dhe rritje të ndërveprueshmërisë sipas standardeve të NATO-s.

Programet e asistencës ushtarake amerikane kanë ndihmuar në rritjen e kapaciteteve operacionale të FA-së, ndërsa ushtarakët shqiptarë kanë përfutur nga programe arsimimi profesional dhe shkëmbimi eksperiencash në institucionet më prestigjioze ushtarake amerikane.

Po ashtu, Shqipëria dhe SHBA kanë bashkëpunuar ngushtë në misionet ndërkombëtare të NATO-s dhe koalicioneve shumëkombëshe në Afganistan, Irak, Kosovë dhe në rajone të tjera ku Aleanca ka kontribuar për ruajtjen e paqes dhe sigurisë.

Ky bashkëpunim ka dëshmuar se partneriteti ndërmjet dy vendeve nuk kufizohet vetëm në deklarata politike, por materializohet çdo ditë përmes angazhimit të përbashkët për sigurinë kolektive.

Deklarata për Partneritet Strategjik

Një moment tjetër i rëndësishëm në historinë e marrëdhënieve shqiptaro-amerikane ishte nënshkrimi, në prill të vitit 2015, i Deklaratës për Partneritet Strategjik ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ky dokument shënoi ngritjen e marrëdhënieve dypalëshe në një nivel më të lartë, duke zgjeruar bashkëpunimin në fusha të tilla si mbrojtja, lufta kundër terrorizmit, siguria kibernetike, zhvillimi ekonomik, energjia dhe forcimi i institucioneve demokratike.

Deklarata konfirmoi se Shqipëria mbetet një partner i besueshëm i SHBA-së në Ballkanin Perëndimor dhe një kontribuuese aktive në sigurinë euroatlantike.

Një aleancë që sheh drejt së ardhmes

Sot, pas 104 vitesh nga vendosja e marrëdhënieve diplomatike, partneriteti mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara mbetet një nga asetet më të rëndësishme strategjike të vendit.

Mbështetja amerikane për procesin e integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, kontributi në modernizimin e sektorit të mbrojtjes dhe angazhimi i përbashkët në kuadër të NATO-s dëshmojnë se kjo marrëdhënie vazhdon të ndërtohet mbi interesa të përbashkëta dhe vlera të qëndrueshme.

Në një mjedis ndërkombëtar gjithnjë e më kompleks, ku sfidat ndaj sigurisë kërkojnë bashkëpunim të ngushtë mes aleatëve, marrëdhëniet shqiptaro-amerikane mbeten një faktor stabiliteti dhe zhvillimi.

Historia e nisur, më 28 korrik 1922, vazhdon të shkruhet edhe sot, përmes partneritetit strategjik, bashkëpunimit ushtarak dhe angazhimit të përbashkët për mbrojtjen e paqes, demokracisë dhe sigurisë. Më shumë se një shekull pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike, Shqipëria dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës vijojnë të ecin krah për krah si aleatë në NATO



dhe partnerë strategjikë, duke dëshmuar se miqësia e ndërtuar mbi besimin dhe vlerat e përbashkëta është një investim afatgjatë për të ardhmen.

Transformimi i universitetit tradicional në universitet 4.0, në epokën e inteligjencës artificiale dhe teknologjisë së avancuar digjitale



MAJOR @ MSC. AGRON BUKAÇI
Specialist/Kërkues në IKSHU/AFA

(Vijon nga numri i kaluar)

Kjo është nxitur nga iniciativa jashtë Kombeve të Bashkuara, të tilla si samitet e IA-së përgjegjëse në fushën ushtarake – *Responsible AI in the Military Domain* (REAIM) dhe Deklarata Politike mbi Përdorimin Ushtarak të Përgjegjshëm të Inteligjencës Artificiale dhe Autonomisë. Këto procese ishin themelore në rritjen e ndërgjegjësimit dhe shërbyen si inkubatorë për veprime politike në skenën ndërkombëtare. Në këtë sfond dhe për shumë vite, *United National Institute for Disarmament Research* (UNIDIR) - Instituti i Kombeve të Bashkuara për kërkime mbi Çarmatimin (IKBKÇ) ka kontribuar ndjeshëm në fillimin dhe formësimin e diskutimeve kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare përmes kërkimit të tij, ndërtimit të kapaciteteve dhe fuqisë së tij organizuese.

Retë Informatike - *Cloud computing*: “Cloud” është vendi ku ruhen, përpunohen dhe analizohen sasitë e mëdha të të dhënave që gjenerohen nga pajisjet IoT. Platformat e *cloud computing* ofrojnë infrastrukturën dhe mjetet që nevojiten për të ruajtur dhe analizuar këto të dhëna, si dhe për të ndërtuar dhe vendosur aplikacione të internetit të gjërave (IoT). Analitika e të dhënave të mëdha, për t'i dhënë kuptim sasive të mëdha të të dhënave të gjeneruara nga pajisjet IoT.

Hapat e hedhur në Shqipëri drejt konceptit të “Universitetit 4.0”

Në Shqipëri janë hedhur hapa konkretë drejt konceptit të “Universitetit 4.0”, përmes prezantimit të raportit të Bordit të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe paralajmërimit për rishikimin e ligjit të arsimit të lartë. Qeveria e ka lidhur këtë transformim me nevojën për të përballuar sfidat e epokës digjitale dhe për t'u afruar me standardet e ekselencës europiane.

Kronologjia e Universitetit 4.0 në Shqipëri 2025 – Raporti i Bordit të Akreditimit

- Prezantohet raporti “Arritjet dhe sfidat drejt Universitetit 4.0”, duke analizuar progresin dhe sfidat e arsimit të lartë në epokën digjitale.

2025 – Paralajmërimi për rishikimin e ligjit

- Kryeministri Edi Rama njofton se ligji i arsimit të lartë do të ndryshohet për të ofruar një ofertë akademike më konkurruese dhe të përgatitur për integrimin në BE.

2025 – Shembulli i Universitetit Bujqësor të Tiranës

- Bashkëpunimi me Universitetin BOKU të Vjenës shërben si model për përmirësimin e sistemit organizativ, ligjor dhe menaxherial.

2026 – Fillimi i reformës ligjore

- Pritet të nisë procesi i rishikimit të ligjit të arsimit të lartë, duke përfshirë mekanizma të rinj për digjitalizim, menaxhim dhe akreditim.

2026–2027 – Digjitalizimi i universiteteve

- Integrimi i platformave digjitale për mësimdhënie, kërkim shkencor dhe administrim. Synohet kalimi drejt një infrastrukture moderne të arsimit.

2027 e tutje – Integrimi europian

- Universitetet shqiptare pritet të afrohen me standardet e ekselencës europiane, duke u bërë më tërheqëse për studentë vendas dhe të huaj, shembull është Universiteti Bujqësor i Tiranës në bashkëpunim me universitetin BOKU të Vjenës.

Nga modeli i universitetit ushtarak tradicional te universiteti ushtarak 4.0.

Në universitetin tradicional ushtarak aplikohet: Mësim i standardizuar, që do të thotë një qasje arsimore ku të gjithë studentët trajtohen sipas të njëjtave rregulla, të njëjtat përmbajtje dhe metoda pa shumë përshtatje individuale; Disiplinë dhe hierarki; Trajnim fizik dominant.

Në universitetin ushtarak 4.0 aplikohet: Mësim adaptiv, ku procesi i të nxënit përshtatet automatikisht me nevojat, ritmin dhe nivelin e çdo studenti. Kjo metodë e mësimi funksionon duke përdorur të dhëna mbi performancën e studentit, algoritme të AI-së dhe platforma digjitale që analizojnë përgjigjet dhe sjelljet gjatë mësimi. Në bazë të këtyre vlerësimeve, nëse studenti ka vështirësi,



sistemi jep shpjegime më të thjeshta, nëse ecën mirë atëherë sistemi kalon në shpjegime më të avancuara, ndryshon edhe mënyra e prezantimit (video, kuize, ushtrime etj.).

Mësimi adaptiv është i rëndësishëm sepse rrit efektivitetin e studentit, kursen kohë, nuk përsërit atë që student di, rrit motivimin, sepse sfidat janë të hapura.

Në konceptin e universitetit ushtarak 4.0 mësimi adaptiv është thelbësor ai kombinohet me analizën e të dhënave, siç e theksuam më lart, të dhënat merren nga sistemi *big data*, kombinohet me platforma online “retë informatike”, kombinohet me IA-në dhe teknologjitë digjitale në sistemet e trajnimit ushtarak.

Në universitetin ushtarak 4.0 mësimi i standardizuar sipas modelit tradicional të universitetit është i domosdoshëm për sigurinë, disiplinën dhe ndërveprimin në grup. Synimi për universitetin 4.0 nuk do të thotë ta braktisim mësimin e standardizuar por ta kombinojmë me fleksibilitet inteligjent.

Për këtë arsye mësimi duhet të ndahet në dy shtresa: Pjesa standard në universitetin ushtarak 4.0, e detyrueshme për t'u aplikuar ku bëjnë pjesë: taktikat bazë, procedurat standarde të veprimit, komandimi dhe siguria ku të gjithë mësojnë njësoj;

Pjesa adaptive, fleksibile, në universitetin ushtarak 4.0, ku bën pjesë: zhvillimi individual, analiza, teknologjia dhe vendimmarrja ushtarake, pra në pjesën e mësimi adaptiv hyn personalizimi:

- përdorim i IA-së
- zhvillimi i simulime të situatave reale pa rrezikshmëri.
- analizë e të dhënave
- disiplinë dhe hierarki
- trajnim fizik

Teknologjitë kryesore që do të aplikohen në Universitetin ushtarak 4.0

- Inteligjenca artificiale
- Personalizim i trajnimit
- Analiza e performancës
- Mbështetje vendimmarrjeje

Transformimi pedagogjik i universitetit ushtarak 4.0

- Nga mësim tradicional → adaptiv
- Nga teori → simulim
- Nga testim → analizë e vazhdueshme
- Ndërfaqja njeri-IA, IA-ja nuk zëvendëson njeriun, por e mbështet atë në vendimmarrje.

Sfidat

- Kosto teknologjike
- Siguri kibernetike
- Etikë
- Trajnimi i stafit

Interneti i gjërave (IoT): IoT mundëson ndërlidhjen e pajisjeve dhe mbledhjen e të dhënave në kohë reale, duke krijuar një sistem të integruar trajnimi.

Big Data - të dhënat e mëdha: Analiza e të dhënave për vendimmarrje strategjike.

Simulimet dixhitale: Virtual Reality (VR) - realiteti virtual (RV) - është një ambient virtual, shkëputur nga realiteti. *Augmented Reality* (AR), realiteti ekzistues “pasurohet” me elementë virtual si p.sh. informacione, objekte 3D etj., për simulimin e fushëbetejës, trajnim për përdorim pajisjesh, skenar emergjencash dhe situatë kritike dhe vendimmarrje në kohë reale duke u trajnuar pa rrezik.

Siguria kibernetike: Mbrojtja e sistemeve digjitale ushtarake është kritike.

Praktika ndërkombëtare lidhur me Inteligjencën Artificiale (AI)

NATO dhe institucionet ndërkombëtare kanë integruar IA-në dhe teknologjitë digjitale në sistemet e trajnimit ushtarak. Strategjia e NATO-s për Inteligjencën Artificiale u miratua gjatë Takimit të Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s, në tetor 2021, me qëllim forcimin e avantazhit teknologjik të NATO-s,

duke adresuar njëkohësisht rreziqet e Inteligjencës Artificiale në operacionet e mbrojtjes dhe sigurisë. Aty theksohet se Inteligjenca Artificiale do të ndikojë në të gjithë spektrin e aktiviteteve të NATO-s, duke përfshirë mbrojtjen kolektive, menaxhimin e krizave dhe sigurinë bashkëpunuese. Strategjia njeh rolin kritik të sektorit privat dhe akademisë në zhvillimin e Inteligjencës Artificiale dhe kërkon të nxisë bashkëpunimin, për një fuqi punëtore të kualifikuar, infrastrukturë të sigurt të të dhënave dhe mbrojtje të fuqishme kibernetike.

Parimet e Përdorimit të Përgjegjshëm të IA-së

Në thelb të strategjisë janë Parimet e NATO-s për përdorimin e përgjegjshëm (PRU), të cilat ofrojnë udhëzime etike, ligjore dhe politike për IA-në në mbrojtje:

- Ligjshmëria:** Aplikacionet e IA-së duhet të jenë në përputhje me ligjin kombëtar dhe ndërkombëtar, duke përfshirë ligjin humanitar dhe të të drejtave të njeriut.
- Përgjegjësia dhe llogaridhënia:** Mbikëqyrja njerëzore është e nevojshme për të siguruar llogaridhënien në vendosjen e IA-së.
- Shpjegueshmëria dhe gjurmueshmëria:** Sistemet e IA-së duhet të jenë transparente dhe të kuptueshme, me mekanizma për verifikim dhe validim.
- Besueshmëria:** IA-ja duhet të funksionojë në mënyrë të vazhdueshme në kushtet e pritura.
- Qeverisja:** Sistemet duhet të mbeten nën kontrollin e njeriut dhe të përshtaten me rrethanat në ndryshim.
- Zbutja e paragjykimeve:** IA duhet të projektohet për të minimizuar paragjykimet dhe diskriminimin e paqëllimshëm.

Përfundime

- Transformimi në universitet 4.0 nuk është thjesht teknologjik, por kulturor dhe organizativ. Adaptimi i IA-së dhe teknologjive të avancuara nuk mjafton nëse universiteti nuk ndryshon mënyrën si mendon, duke u transformuar nga një institucion që transmeton dije në një ekosistem që krijon, teston dhe aplikon dije në kohë reale.

- Roli i pedagogut ndryshon rrënjësisht, pedagogu nuk është më burimi kryesor i informacionit, por bëhet mentor, kurator dhe udhëheqës i të mësuarit kritik. IA-ja mund të japë përmbajtje, por jo orientim etik, kritik dhe njerëzor.

- Studenti bëhet aktor aktiv dhe i personalizuar, mësimi kalon nga “*one-size-fits-all*” - “një mënyrë e vetme për të gjithë”, në trajektore individuale të mbështetura nga analiza e të dhënave dhe intelijenca artificiale (*adaptive learning*).

- Ndërlidhja me tregun dhe industrinë bëhet thelbësore, universiteti 4.0 funksionon si pjesë e një ekosistemi me biznesin, startup-et dhe kërkimin shkencor, ku inovacioni dhe punësueshmëria janë të integruara në kurikulum.

- Kurrikulat bëhen dinamike dhe ndërdisiplinore, programet duhet të përditësohen vazhdimisht dhe të kombinojnë fusha (p.sh. teknologji + ekonomi + etikë), për t’iu përgjigjur zhvillimeve të shpejta.

- Rritet rëndësia e kompetencave “të buta” dhe etike, në një botë me IA, aftësi si mendimi kritik, kreativiteti, vendimmarrja dhe etika bëhen po aq të rëndësishme sa njohuritë teknike.

- Sfida të forta në infrastrukturë dhe barazi, jo të gjitha universitetet kanë kapacitete të njëjta teknologjike; ekziston rreziku i thellimit të pabarazive (digjitale dhe sociale).

- Çështjet etike dhe të sigurisë janë kritike, përdorimi i IA-së ngre pyetje për privatësinë, plagjiaturën, integritetin akademik dhe rolin e njeriut në vendimmarrje.

- Universiteti si platformë e hapur dhe e vazhdueshme (*lifelong learning*), mësimi nuk mbaron me diplomën - Universiteti 4.0 ofron trajnime të vazhdueshme, mikrokredite dhe fleksibilitet gjatë gjithë jetës.

- Suksesi varet nga strategjia dhe udhëheqja, institucionet që kanë vizion të qartë, investim të qëndrueshëm dhe menaxhim të mirë të ndryshimit do të jenë fituese, të tjerat rrezikojnë të mbeten pas.

- Transformimi drejt Universitetit 4.0 është një rikonceptim i plotë i arsimit të lartë, ku teknologjia është mjet, por ndryshimi real ndodh në mendësi, strukturë dhe qëllim.
- Universiteti Ushtarak 4.0 përfaqëson një paradigmë të re të edukimit ushtarak. Integrimi i IA-së, IoT dhe *Big Data* rrit ndjeshëm cilësinë e trajnimit dhe gatishmërinë operacionale.

- Universiteti ushtarak 4.0 përfaqëson një transformim paradigmatic që kërkon ristrukturim të kurikulumave, investime teknologjike dhe zhvillim të kompetencave të reja. Ky model rrit ndjeshëm efikasitetin e trajnimit dhe gatishmërinë operacionale.

- Në Universitetin ushtarak 4.0 nuk mund të hiqet dorë nga mësimi i standardizuar por duhet të evoluohet në një model: standardizim në bazë plus adaptim në zhvillim.

- Në Universitetin ushtarak 4.0 duhet të aplikohet vlerësimi i përzier, i cili konsiston në aplikimin e testeve standarde në vlerësimet për njohuritë bazë dhe testet dhe vlerësim individual.

- Universiteti ushtarak 4.0 nuk ka qëllim të përgatisë individë identik por individë që të gjithë të punojnë në mënyrë perfekte së bashku gjatë studimeve edhe nëse kanë aftësi të ndryshme.

AGIM H. LIKA – NJË ZËI VLERAVE USHTARAKE, HISTORIKE DHE LETRARE

Ka njerëz që e përmbushin misionin e tyre me uniformë, por ka edhe nga ata që vazhdojnë t'i shërbejnë vendit edhe pasi e kanë varur atë në gardërobë. Nënkolonel (R) **Agim H. Lika** është një prej këtyre personaliteteve, që ka ditur ta shndërrojë përvojën ushtarake në një mision të ri, atë të studiuesit, historianit dhe krijuesit letrar.

I lindur në vitin 1968, në Shetaj të Durrësit, ai ka ndërtuar një karrierë të gjatë dhe të suksesshme në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, duke shërbyer për më shumë se tri dekada në detyra të rëndësishme drejtuese, pedagogjike dhe administrative, deri në përfundimin e shërbimit aktiv në vitin 2020. Profesionalizmi, korrektësia dhe përkushtimi i tij ndaj institucionit ushtarak janë vlerësuar me medalje dhe dekorata shërbimi e karriere.

Por kontributi i Agim Likës nuk përfundon me misionin ushtarak. Ai është autor i disa botimeve me karakter studimor, historik dhe poetik, duke dëshmuar se kultura ushtarake mund të bashkëjetojë natyrshëm me ndjeshmërinë artistike dhe kërkimin shkencor.



NGA AGIM H. LIKA

**Nënkolonel (R), poet, historian
dhe studiues**

Historia e një ushtrie nuk ndërtohet vetëm nga betejat, armatimet apo reformat institucionale. Ajo ndërtohet mbi njerëzit që i kanë shërbyer me përkushtim, mbi sakrificat e tyre dhe mbi vlerat që ata mbartin edhe pasi largohen nga shërbimi aktiv. Pikërisht për këtë arsye, respekti ndaj ushtarakut nuk duhet të kufizohet në periudhën kur ai mban uniformën, por duhet të jetë pjesë e kulturës institucionale të një shteti demokratik.

Ushtaraku shqiptar, qoftë në shërbim aktiv, rezervist, në lirim, në rezervë apo në pension, përfaqëson një pasuri njerëzore dhe profesionale që nuk humbet me kalimin e viteve. Ai mbetet bartës i disiplinës, përgjegjësisë, etikës së shërbimit dhe ndjenjës së detyrës ndaj atdheut.

Në çdo shoqëri moderne, ushtria konsiderohet një nga institucionet që formon karakterin qytetar. Për këtë arsye, ish-ushtaraku nuk duhet parë si një profesionist që ka përfunduar karrierën, por si një burim eksperience që vazhdon të kontribuojë në jetën publike.

Përtej uniformës, një identitet që mbetet

Uniforma është simboli më i dukshëm i profesionit ushtarak, por nuk është vetë identiteti i ushtarakut. Pas saj qëndron një kulturë e tërë formimi, sakrifice dhe përgjegjësie. Vitet e shërbimit ndërtojnë një mënyrë të veçantë të të menduarit, ku interesi kombëtar vendoset mbi interesin personal, ku fjala “detyrë” ka peshë reale dhe ku disiplinës nuk i jepet kuptim vetëm si rregull, por si mënyrë jetese.

Këto cilësi nuk zhduken me daljen në pension. Përkundrazi, ato shndërrohen në një kapital njerëzor që mund t'i shërbejë administratës publike, arsimit, biznesit, diplomacisë, medias dhe komunitetit.

Përvoja ndërkombëtare dëshmon se shtetet që respektojnë ushtarakët e tyre ndërtojnë institucione më të forta dhe shoqëri më të ndërgjegjshme për rëndësinë e sigurisë kombëtare.

Reformat dhe sfidat e tranzicionit

Transformimet e mëdha pas viteve '90 prekën ndjeshëm edhe Forcat e Armatosura Shqiptare. Ristrukturimet, modernizimi dhe integrimi në NATO sollën një ushtri më profesionale, por njëkohësisht ndryshuan rrënjësisht jetën e mijëra ushtarakëve.

Shumë prej tyre u larguan nga shërbimi në një moshë ende aktive, duke u përballur me sfidën e integritetit në jetën civile.

Megjithatë, koha tregoi se formimi ushtarak ishte një avantazh. Disiplina, aftësitë organizative, menaxhimi i krizave dhe përgjegjësia profesionale u bënë elementë që i ndihmuan shumë ish-ushtarakë të ndërtonin karriera të suksesshme në fusha të ndryshme.

Ky është një potencial që meriton të vlerësohet më

Aktualisht ai vijon të kontribuojë si bashkautor i librit **“Ishmi në Regjistrimin Austro-Hungarez 1918”**, një punim me rëndësi për kujtesën historike dhe identitetin kulturor të krahinës së Ishmit.

Gazeta “Ushtria” vlerëson kontributin e nënkolonelit në rezervë **Agim H. Lika** si një prej zërave më seriozë dhe të respektuar të mendimit ushtarak shqiptar. Shkrimet e tij mbështeten në një përvojë të gjatë profesionale, në njohjen e thellë të institucionit ushtarak dhe në një ndjenjë të spikatur përgjegjësie qytetare. Në një kohë kur debati mbi vlerat, identitetin dhe rolin e institucioneve në shoqëri bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm, reflektimet e tilla shërbejnë si një kontribut me vlerë për ruajtjen e kujtesës institucionale dhe promovimin e kulturës së respektit ndaj njerëzve që i kanë shërbyer vendit.

Në vijim botojmë analizën e tij me titull **“Ushtaraku shqiptar përtej uniformës: Dinjiteti, kujtesa dhe kultura e respektit”**, një reflektim mbi marrëdhënien që shteti dhe shoqëria duhet të ndërtojnë me ushtarakët pas përfundimit të shërbimit aktiv.

USHTARAKU SHQIPTAR PËRTEJ UNIFORMËS: DINJITETI, KUJTESA DHE KULTURA E RESPEKTIT

Uniforma është simboli më i dukshëm i profesionit ushtarak, por nuk është vetë identiteti i ushtarakut. Pas saj qëndron një kulturë e tërë formimi, sakrifice dhe përgjegjësie. Vitet e shërbimit ndërtojnë një mënyrë të veçantë të të menduarit, ku interesi kombëtar vendoset mbi interesin personal, ku fjala “detyrë” ka peshë reale dhe ku disiplinës nuk i jepet kuptim vetëm si rregull, por si mënyrë jetese.

shumë nga institucionet shtetërore.

Shkolla “Skënderbej”, një akademi karakteri

Një kapitull i rëndësishëm i historisë së arsimit ushtarak shqiptar mbetet Shkolla e Mesme Ushtarake “Skënderbej”.

Nga kjo vatrë dolën jo vetëm komandantë dhe drejtues ushtarakë, por edhe studiues, profesorë, diplomatë, ekonomistë, artistë dhe personalitete të jetës publike.

Ata dëshmuar se edukimi ushtarak nuk prodhon vetëm profesionistë të mbrojtjes, por qytetarë me ndjenjë të fortë përgjegjësie dhe lidhshipi.

Ky trashëgim përbën një pjesë të rëndësishme të kujtesës institucionale të vendit dhe duhet të ruhet e të promovohet si pjesë e historisë së Forcave të Armatosura.

Respekti nuk është privilegj

Një shoqëri matet edhe nga mënyra se si trajton ata që kanë shërbyer për të.

Respekti ndaj ushtarakëve nuk është privilegj dhe as favor institucional. Ai është një detyrim moral dhe një shprehje e mirënjohjes së shtetit ndaj njerëzve që kanë qenë të gatshëm të sakrifikojnë gjithçka për mbrojtjen e vendit.

Ky respekt nuk shprehet vetëm në ceremoni apo dekorata. Ai reflektohet në kujdesin institucional, në ruajtjen e dinjitetit social, në dëgjimin e përvojës së tyre dhe në përfshirjen e tyre në jetën publike.

Ushtaraku në pension nuk është një figurë e së kaluarës; ai është pjesë aktive e memories kombëtare.

Kujtesa si pjesë e sigurisë kombëtare

Ruajtja e kujtesës ushtarake është një investim për të

Respekti ndaj ushtarakëve nuk është privilegj dhe as favor institucional. Ai është një detyrim moral dhe një shprehje e mirënjohjes së shtetit ndaj njerëzve që kanë qenë të gatshëm të sakrifikojnë gjithçka për mbrojtjen e vendit. Ky respekt nuk shprehet vetëm në ceremoni apo dekorata. Ai reflektohet në kujdesin institucional, në ruajtjen e dinjitetit social, në dëgjimin e përvojës së tyre dhe në përfshirjen e tyre në jetën publike.

ardhmen.

Historitë personale të ushtarakëve, përvoja e tyre në misione, në stërvitje apo në drejtimin e institucioneve, përbëjnë një pasuri që duhet dokumentuar dhe transmetuar.

Në këtë aspekt, botimet, studimet dhe dëshmitë e ish-ushtarakëve marrin një vlerë të veçantë.

Ato nuk janë vetëm rrëfime individuale, por pjesë e historisë së Forcave të Armatosura dhe e identitetit kombëtar.

Një kulturë e re respekti

Në një kohë kur Shqipëria është pjesë e NATO-s dhe synon të forcojë më tej kapacitetet e saj mbrojtëse, është po aq e rëndësishme të ndërtohet edhe një kulturë më e fortë respekti për njerëzit e uniformës. Ky respekt duhet të fillojë që në edukimin qytetar, të vazhdojë në institucionet shtetërore dhe të pasqyrohet në mënyrën se si media dhe opinionin publik flasin për ushtarakët. Sepse ushtria nuk është vetëm një institucion, ajo është një komunitet njerëzish që i kanë kushtuar jetën mbrojtjes së vendit.

Ushtaraku shqiptar mbetet ushtarak edhe kur nuk mban më uniformën. Ai vazhdon të jetë pjesë e identitetit të Forcave të Armatosura dhe e historisë së shtetit shqiptar.

Prandaj, dinjiteti, kujtesa dhe kultura e respektit nuk janë vetëm vlera morale. Ato janë elemente të domosdoshme për forcimin e institucioneve demokratike dhe të ndërgjegjes kombëtare.

Një shtet që nderon ushtarakët e tij nderon vetveten. Dhe një shoqëri që ruan kujtesën e tyre ndërton me më shumë siguri të ardhmen.

Kur guximi kishte emër gruaje: Krisulla Kaçi Prifti, një jetë në shërbim të Shqipërisë



KAPITEN (P) VERI TALUSHLLARI

Krisulla Kaçi Prifti, një nga pionieret e grave shqiptare me uniformë

Në historinë e Forcave të Armatosura Shqiptare ka emra që mbeten dëshmi e një epoke, por edhe frymëzim për brezat që vijnë. Një ndër to është kolonelja në pension Krisulla Kaçi Prifti, pjesë e brezit të parë të vajzave shqiptare që zgjodhën profesionin e armës në fundin e viteve '60, duke hapur një rrugë të re për rolin e gruas në institucionet e mbrojtjes dhe të sigurisë.

Jeta dhe karriera e saj përfaqësojnë historinë e një gruaje që ndërtoi gjithçka mbi disiplinën, profesionalizmin dhe përkushtimin ndaj detyrës, duke lënë gjurmë si në ushtri, ashtu edhe në sistemin e rendit publik.

Nga Dropulli drejt rrugës së uniformës

Krisulla Kaçi lindi në vitin 1949 në Krioner të Dropullit, në qarkun e Gjirokastrës. Arsimin e mesëm e përfundoi në gjimnazin e njohur "Asim Zeneli" në Gjirokastrë, një shkollë që ka nxjerrë shumë personalitete të jetës shqiptare.

Në vitin 1967 ajo mori një vendim që për kohën ishte sa i guximshëm, aq edhe historik: iu bashkua Kursit të Parë të Vajzave Shqiptare në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve "Enver Hoxha", në degën e këmbësorisë.

Në një kohë kur profesioni ushtarak konsiderohej pothuajse ekskluzivisht mashkullor, Krisulla dhe bashkëmoshataret e saj dëshmuar se aftësia, përgjegjësia dhe vendosmëria nuk kanë gjini.

Përveç formimit ushtarak, ajo kreu edhe studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës, duke pasuruar profilin profesional me njohuri juridike që do t'i shërbenin më vonë në detyrat drejtuese.



Një karrierë në shërbim të shtetit

Rruga profesionale e Krisulla Kaçi Priftit është e pasur dhe e larmishme. Karrierën e nisi si instruktore stërvitjeje në Brigadën e 4-t të Mbrojtjes Bregdetare në Durrës, ku spikati për aftësitë organizative dhe disiplinën ushtarake.

Më pas shërbeu si instruktore në Korpusin e Tiranës dhe në strukturat e rinisë shkollore universitare, duke marrë përgjegjësi gjithnjë e më të mëdha. Ajo mbajti detyrën e komisarit në Shkollën e Lartë Ushtarake, më pas u emërua shefe shtabi batalioni, ndërsa më vonë drejtoi sektorin e personelit në Gardën e Republikës.

Kontributi i saj nuk u kufizua vetëm në strukturat ushtarake

Si pedagoge dhe më pas shefe katedre në Akademinë e Policisë, Krisulla Kaçi Prifti dha një ndihmesë të rëndësishme në përgatitjen profesionale të brezave të rinj të efektivëve, ndërsa më pas shërbeu edhe si specialiste në



Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Pas një karriere të gjatë në shërbim të institucioneve të sigurisë kombëtare, ajo doli në pension në vitin 2006.

Gruaja që nuk reshti së shërbyeri

Edhe pas daljes në pension, lidhja me uniformën nuk u ndërpre. Në vitin 2008 emigroi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku jeton në Queens, New York, së bashku me familjen. Megjithatë, edhe larg Shqipërisë, Krisulla mbeti e lidhur ngushtë me komunitetin ushtarak shqiptar. Që prej themelimit të saj, më 10 dhjetor 2017, ajo është anëtare aktive e Shoqatës së Ushtarakëve Shqiptaro-Amerikanë "Skënderbej", duke kontribuar në ruajtjen e traditës, historisë dhe vlerave të ushtarakëve shqiptarë në diasporë.

Për të, uniforma nuk ka qenë thjesht një profesion, por një identitet që vazhdon ta përfaqësojë edhe sot.



Një model për brezat

Ata që kanë punuar me Krisullën flasin për një oficerë me autoritet profesional, por njëkohësisht me komunikim njerëzor, kulturë të gjerë dhe ndjenjë të lartë përgjegjësie. Ajo diti të fitonte respekt jo përmes privilegjeve, por falë punës, aftësive dhe karakterit të saj.

Misionare e emancipimit të gruas

Historia e grave të para oficerë shqiptare është pjesë e historisë së emancipimit të shoqërisë shqiptare.

Në këtë histori, Krisulla Kaçi Prifti zë një vend të veçantë. Ajo dhe koleget e saj dëshmuar se gruaja mund të mbante me dinjitet uniformën ushtarake, të drejtonte struktura, të përballonte përgjegjësi dhe të ishte

shembull profesionalizmi. Kontributi i tyre nuk kufizohet vetëm në aspektin ushtarak.

Ato ndryshuan perceptimin për rolin e gruas në institucionet e sigurisë dhe krijuan mundësi të reja për brezat që erdhën më pas.

Sot, kur në Forcat e Armatosura shqiptare shërbejnë qindra gra në çdo nivel drejtimi, rruga e tyre mbështetet mbi themelet që ndërtuan pionieret e viteve '60 dhe '70.



Trashëgimia e një oficerje

Pas më shumë se katër dekadash shërbim, Krisulla Kaçi Prifti mbetet një figurë e respektuar mes kolegëve dhe komunitetit ushtarak shqiptar, brenda dhe jashtë vendit.

Ajo është bashkëshorte e Virgjil Priftit, nënë e Enkelejdës dhe Enisit dhe gëzon lumturinë e pesë nipërve e mbesave.

Historia e saj është historia e një jete të ndërtuar mbi përgjegjësinë, dijen dhe dashurinë për atdheun.

Në galerinë e grave shqiptare me uniformë, emri i Krisulla Kaçi Priftit mbetet simbol i brezit që hapi rrugën për pjesëmarrjen e gruas në institucionet ushtarake dhe të sigurisë, duke dëshmuar se profesionalizmi, integriteti dhe përkushtimi janë vlera që nuk njohin dallim gjinor.

"Portreti i Krisulla Kaçi Priftit është portreti i një gruaje që e veshi uniformën me krenari, e i shërbeu shtetit me dinjitet dhe la pas një trashëgimi që vazhdon të frymëzojë gratë shqiptare në Forcat e Armatosura dhe në institucionet e sigurisë".

Ruajtja e kujtesës historike, një mision i Redaksisë së Shtypit Ushtarak

Portrete si ai i Krisulla Kaçi Priftit janë pjesë e historisë së gjallë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Përmes tyre nuk evidentohen vetëm karrierat individuale, por edhe rrugëtimi i institucionit ushtarak, zhvillimi i rolit të gruas në uniformë dhe kontributi i brezave që shërbyen me përkushtim ndaj atdheut.

Pikërisht për këtë arsye, **Redaksia e Shtypit Ushtarak - gazeta "Ushtria"-revista "Mbrojtja"** i kanë kushtuar një hapësirë të veçantë rubrikës **"Portret"** me synimin për të dokumentuar dhe përcjellë historitë e grave dhe burrave që kanë lënë gjurmë në historinë e Forcave të Armatosura.

Këto portrete nuk janë vetëm një vlerësim për individin, por edhe një kontribut në ruajtjen e memories institucionale, duke sjellë për lexuesit modele frymëzuese të profesionalizmit, integritetit dhe përkushtimit.

Në këtë mozaik figurash të spikatura, vend të merituar zë edhe Krisulla Kaçi Prifti, një nga vajzat e para oficerë shqiptare, e cila me punën, karakterin dhe përkushtimin e saj u bë pjesë e historisë së emancipimit të gruas në uniformë. Përmes pasqyrit të këtyre personaliteteve, **gazeta "Ushtria"** jo vetëm nderon kontributin e tyre, por edhe krijon një urë lidhëse mes brezit të pionierëve dhe ushtarakëve të rinj, duke përcjellë vlerat më të mira të shërbimit ushtarak.

Kjo rubrikë është një dëshmi se historia e Forcave të Armatosura nuk shkruhet vetëm nga ngjarjet dhe operacionet, por edhe nga njerëzit që, me përkushtimin e tyre të përditshëm, kanë ndërtuar traditën dhe identitetin e institucionit.

Në këtë mënyrë, Redaksia e Shtypit Ushtarak vijon misionin e saj për të ruajtur, dokumentuar dhe promovuar trashëgiminë e vyer të ushtrisë shqiptare, duke i dhënë vendin e merituar edhe grave që kanë shërbyer me nder në uniformën e Forcave të Armatosura.



PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

Skënder Qemal Xhixho, polici që e ktheu detyrën në akt sublim shërbimi ndaj Republikës

Historia e shtetit shqiptar është ndërtuar mbi përkushtimin dhe sakrificën e njerëzve të uniformës. Në kohë paqeje apo në periudha sfidash, ushtarakët dhe punonjësit e Policisë së Shtetit kanë qenë në vijën e parë të mbrojtjes së interesit publik, të rendit kushtetues dhe të sigurisë së qytetarëve. Ata i përkasin institucioneve të ndryshme, por ndajnë të njëjtin betim: t'i shërbejnë Shqipërisë, edhe me çmimin më të lartë, jetën.

Pikërisht për këtë arsye, **Gazeta “Ushtria”** e konsideron kujtesën e dëshmorëve një pasuri të përbashkët të të gjitha institucioneve të sigurisë dhe mbrojtjes. Dëshmorët e Policisë së Shtetit, njësoj si dëshmorët e Forcave të Armatosura, janë pjesë e historisë së shtetit shqiptar. Ata nuk mbrojtën vetëm një institucion, por vetë autoritetin e Republikës, rendin ligjor dhe jetën e qytetarëve.

Në këtë frymë, gazeta sjell për lexuesit historinë e **Skënder Qemal Xhixhos**, Dëshmor i Policisë së Shtetit dhe Dëshmor i Atdheut, një emër që simbolizon përkushtimin ndaj detyrës dhe sakrificën në mbrojtje të ligjit. Historia e tij është një histori që i përket jo vetëm Policisë së Shtetit, por gjithë familjes së njerëzve të uniformës shqiptare.

Ky material mbështetet në studimin e **Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemit**, një prej studiuesve më të njohur të historisë ushtarake dhe të kujtesës institucionale shqiptare. Përmes dokumenteve arkivore, dëshmimeve dhe burimeve zyrtare, autori sjell jo vetëm jetën e një polici të rënë në krye të detyrës, por edhe mesazhin se sakrifica për shtetin nuk njih dallime uniforme. Ajo mbetet pjesë e identitetit kombëtar dhe e kujtesës sonë institucionale. Materiali i autorit dokumenton rolin e Policisë së Shtetit dhe sakrificën e Skënder Qemal Xhixhos në mbrojtje të rendit dhe ligjit.

SKËNDER QEMAL XHIXHO – DËSHMOR I POLICISË, KRENARI E KAGJINASIT

Kur shërbimi ndaj ligjit bëhet mision deri në flijim

Në historinë e Policisë së Shtetit ka emra që nuk kujtohen vetëm për detyrën që kanë kryer, por për mënyrën se si e kanë përmbushur atë. Janë emra që dëshmojnë se uniforma nuk është thjesht një profesion, por një përgjegjësi ndaj shtetit dhe qytetarëve. Një prej tyre është Skënder Qemal Xhixho, i cili u bë simbol i përkushtimit në vitet më të vështira të tranzicionit shqiptar.

I lindur më 4 prill 1965, në fshatin Kagjinas të Kolonjës, ai u rrit me vlerat e punës, ndershmërisë dhe respektit për komunitetin. Pas përfundimit të arsimit tetëvjeçar në Novoselë dhe shkollës së mesme në Ersekë, ku u diplomua në degën e zooteknikës, punoi në vendlindje deri në fillim të viteve ‘90. Ishin vite të ndryshimeve të mëdha politike dhe shoqërore, kur shteti shqiptar po rindëronte institucionet e tij dhe rendi publik përballë sfidave të jashtëzakonshme.

Në këtë moment vendimtar për vendin, Skënder Xhixho zgjodhi t'i bashkohej Policisë së Shtetit. Më 16 tetor 1991, ai veshi uniformën blu dhe nisi shërbimin në Degën e Rendit Publik në Ersekë. Ishte fillimi i një rrugëtimi të shkurtër në kohë, por të madh në përmbajtje.

Kolegët e kujtojnë si një punonjës korrekt, të qetë dhe të përkushtuar, që e konsideronte zbatimin e ligjit një detyrim moral ndaj qytetarëve. Në vitet kur kriminaliteti, kontrabanda dhe pasiguria sfidonin çdo ditë autoritetin e shtetit, ai ishte ndër policët që nuk u tërhoqën përballë rrezikut, por vijuan të kryenin detyrën me përgjegjësi dhe profesionalizëm. Jeta dhe rrugëtimi i tij profesional përshkruhen në materialin studimor të **Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemit**.

Nata kur detyra u pagua me jetën

Vitet e para të tranzicionit ishin ndër më të vështirat për institucionet shqiptare. Policia e Shtetit përballej çdo ditë me kontrabandën, kriminalitetin dhe sfida të shumta që shoqëronin një vend në ndryshim. Në këto rrethana, shërbimi policor ishte shumë më tepër se një detyrë

DËSHMORËT E SHTETIT, KUJTESA QË BASHKON TË GJITHË NJERËZIT E UNIFORMËS



Asoc. Dr. Zaho Golemit. Sakrifica e Skënder Xhixhos nuk shihet vetëm si historia personale e një polici të ri, por si pjesë e historisë së ndërtimit të shtetit shqiptar në vitet e demokracisë.

Për këtë arsye, Gazeta **“Ushtria”** e konsideron këtë histori një pjesë të memories së përbashkët të njerëzve të uniformës. Përtej dallimeve të institucioneve, misioni mbetet i njëjtë: mbrojtja e Republikës dhe e qytetarëve të saj.

Nga Kagjinasë në kujtesën kombëtare

Skënder Qemal Xhixho lindi në Kagjinas, një krahinë që historia e ka lidhur me sakrificën për lirinë dhe shtetin shqiptar.

Emri i tij sot është gdhendur në lapidarin e vendlindjes, krahas dëshmorëve të tjerë të rënë në periudha të ndryshme të historisë. Ky nuk është vetëm një akt përkujtimor, por një dëshmi se breza të ndryshëm shqiptarësh kanë sakrifikuar jetën për të njëjtin ideal, mbrojtjen e atdheut dhe të shtetit.

Në vitin 2005, me vendim të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, Skënder Qemal Xhixho u shpall **Dëshmor i Atdheut**, ndërsa familja e tij mori statusin “Familje e Dëshmorit”. Ky vlerësim institucional ishte njohje e sakrificës së tij në mbrojtje të ligjit dhe të rendit publik.

Kujtesa nuk është vetëm histori, por përgjegjësi

Institucionet e sigurisë nuk ndërtohen vetëm mbi ligje, struktura dhe pajisje moderne. Ato ndërtohen mbi kujtesën.

Çdo brez që vesh uniformën duhet të njohë historinë e atyre që kanë shërbyer përpara tij, sepse pikërisht në këto histori gjenden shembujt më të mirë të përkushtimit, integritetit dhe besnikërisë ndaj betimit.

Për këtë arsye, figura si ajo e Skënder Qemal Xhixhos nuk duhet të kujtohen vetëm në përvjetorë. Ato duhet të jenë pjesë e edukimit profesional dhe moral të brezave të rinj të Policisë së Shtetit, të Forcave të Armatosura dhe të gjithë strukturave të sigurisë.

Kujtesa institucionale është një nga shtyllat që forcon identitetin e institucioneve.

Sakrifica e njerëzve të uniformës nuk njih ndarje mes ushtrisë dhe policisë. Ajo ka vetëm një emër: **shërbim ndaj Shqipërisë**.

Historia e **Skënder Qemal Xhixhos** dëshmon se pas çdo uniforme fshihet një njeri me familje, ëndrra dhe jetë, i gatshëm të vendosë detyrën mbi gjithçka tjetër. Pikërisht kjo e bën sakrificën e tij pjesë të kujtesës sonë kombëtare.

Duke sjellë këtë material, bazuar në studimin dokumentar të **Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemit**, **Gazeta “Ushtria”** i bashkohet nderimit për të gjithë dëshmorët e shtetit shqiptar, ushtarakë e punonjës policie, të cilët me gjakun dhe përkushtimin e tyre kanë mbrojtur institucionet e Republikës.

Sepse një shtet është aq i fortë sa është kujtesa që ruan për bijtë e tij më të mirë. Emra si Skënder Qemal Xhixho mbeten përgjithmonë pjesë e historisë së nderit, detyrës dhe sakrificës së njerëzve të uniformës.

administrative, ai ishte një përballje e përditshme me rrezikun. Një prej atyre që u gjend në vijën e parë ishte polici **Skënder Qemal Xhixho**.

Në orët e para të mëngjesit të **13 qershorit 1994**, gjatë një operacioni për ndalimin e automjeteve të dyshuara për veprimtari të paligjshme, patrulla e Policisë së Ersekës ngriti një postbllok kontrolli. Një automjet nuk iu bind urdhrat për ndalim dhe, duke lëvizur me shpejtësi të madhe, goditi policin Skënder Xhixho, i cili ndodhej në krye të detyrës.

I plagosur rëndë, ai u transportua me urgjencë drejt Spitalit Ushtarak në Tiranë. Mjekët luftuan për t'i shpëtuar jetën, por pas tri ditësh ai ndërroi jetë. Ishte vetëm 29 vjeç.

Ai nuk humbi jetën në një aksident të zakonshëm. Ai ra gjatë përmbushjes së detyrës, duke mbrojtur ligjin dhe autoritetin e shtetit. Kjo është arsyeja pse emri i tij renditet sot mes dëshmorëve të Policisë së Shtetit dhe të Republikës së Shqipërisë. Rrethanat e ngjarjes dhe operacioni policor dokumentohen në burimet e autorit.

Një sakrificë që i përket gjithë shtetit

Në çdo vend demokratik, rënia e një punonjësi policie në krye të detyrës nuk konsiderohet vetëm humbje për institucionin ku ai shërben.

Ajo është një humbje për vetë shtetin. Sepse polici, ushtaraku, gardisti apo çdo njeri tjetër i uniformës nuk mbron vetëm një strukturë administrative; ai mbron rendin kushtetues, sigurinë publike dhe besimin e qytetarëve tek institucionet.

Pikërisht ky është edhe mesazhi që përcjell studimi i Prof.



Malta, ishulli që teston të ardhmen e energjisë diellore

Studiuesit po përdorin kushtet e vështira të motit të Maltës për të testuar panelet diellore në terren, për të trajnuar teknikë dhe për të zhvilluar mjete që mund të ndihmojnë në funksionimin e paneleve për një kohë më të gjatë në të gjithë Evropën.

Studiuesit testojnë panelet diellore në kushtet e vështira të Maltës për të zhvilluar mjete që i mbajnë ato në punë më gjatë.

Me rreth 3 000 orë diell në vit, Malta është në një pozicion ideal për të shfrytëzuar energjinë e diellit. Por verat e saj përvëluese, ajri i kripur i detit dhe stuhitë e pluhurit të Saharasë herë pas here e bëjnë atë një nga mjediset më të vështira të Evropës për panelet diellore.

Për Dr. Brian Azzopardi, një studiues i energjisë së rinovueshme nga Malta, këto kushte sfiduese paraqesin një mundësi unike. Nëse panelet diellore mund t'i rezistojnë klimës së ishullit, ato duhet të performojnë mirë pothuajse kudo në Evropë. Azzopardi është kryetar i Fondacionit për Inovacion dhe Kërkim - Maltë, një organizatë që ndihmoi në krijimin e një ure midis kërkimit akademik dhe industrisë.

Gjatë tre viteve të fundit, ai ka udhëhequr një iniciativë kërkimore të financuar nga BE të quajtur PROMISE që shqyrtoi mënyra të reja për të përmirësuar monitorimin, mirëmbajtjen dhe besueshmërinë e sistemeve fotovoltaike (PV) në Maltë, me mësimet të mundshme për pjesën tjetër të Evropës.

Zgjerimi diellor i Maltës

Gjatë dekadës së fundit, grantet qeveritare dhe skemat komunitare kanë ndihmuar që energjia diellore të përhapet me shpejtësi në të gjithë ishullin, i cili është shtëpia e rreth 580,000 banorëve: një numër që rritet çdo verë me turistë.

“Që nga rreth vitit 2010, kemi kaluar nga pothuajse zero konsum i energjisë diellore në rreth 20-22%”, - tha Azzopardi.

Megjithatë, ndërsa energjia diellore është zgjeruar, ka dalë në pah një sfidë e re. Gabimet në sistemet fotovoltaike shpesh kalojnë pa u vënë re derisa prodhimi i energjisë elektrike të ketë dështuar tashmë. Deri në atë pikë, dëmtimi i paneleve mund të jetë tashmë i konsiderueshëm.

Për të kapur problemet më herët, studiuesit zhvilluan binjakë dixhitalë: kopje dixhitale të instalimeve reale diellore që lejojnë testimin e skenarëve të ndryshëm dhe identifikimin e defekteve të mundshme para se të ndikojnë në panele.

“Këto sisteme po testohen në kushte shumë të vështira në Maltë. Nëse mbijetojnë këtu, duhet të mbijetojnë kudo në Evropë”, - Dr. Brian Azzopardi.

Ata gjithashtu zhvilluan mjete të inteligjencës artificiale që skanojnë të dhënat hyrëse 24 orë në ditë, duke sinjalizuar automatikisht defektet në vend që të prisnin që dikush të vinte re një dështim në performancë. Hulumtimi u përqendrua gjithashtu në zhvillimin e gjeneratës së ardhshme të specialistëve të energjisë diellore. Sektori diellor në rritje të shpejtë i Maltës ende nuk ka mjaftueshëm teknikë dhe studiues me ekspertizë e nevojshme për të mbajtur sistemet në funksionim efikas.

Duke trajnuar njerëzit në nivel lokal dhe duke ndarë atë që mësojnë ndërkombëtarisht, ekipi shpreson që përvoja e Maltës mund t'i sjellë dobi pjesës tjetër të Evropës.

Për ta arritur këtë, studiuesit kombinuan monitorimin e teknologjisë së lartë në 10 Laboratorë të Gjallë - vende testimi në botën reale - me qasje të reja ndaj besueshmërisë, arsimit dhe trajnimit fotovoltaike, duke përfshirë shkollat ndërkombëtare verore që tërheqin studentë nga e gjithë bota.

Mirëmbajtja ka rëndësi

Përdorimi i energjisë diellore, paralajmëroi Azzopardi, është vetëm gjysma e historisë. “Ju shihni panele diellore në

Me rreth 3 000 orë diell në vit, Malta është në një pozicion ideal për të shfrytëzuar energjinë e diellit. Por verat e saj përvëluese, ajri i kripur i detit dhe stuhitë e pluhurit të Saharasë herë pas here e bëjnë atë një nga mjediset më të vështira të Evropës për panelet diellore.

çati, por nëse ato po funksionojnë siç duhet është ende një pikëpyetje. Mirëmbajtja ka rëndësi gjithashtu.”

Shumica e sistemeve diellore në Maltë janë të vogla dhe në pronësi private, kështu që pronarët e tyre nuk mund të mbështeten në kontrata të mëdha mirëmbajtjeje ose sisteme të sofistikuar monitorimi. Shumë supozonin se pasi të instaloheshin panelet, do të nevojitej pak vëmendje e mëtejshme.

“Është e vërtetë që ka pak pjesë lëvizëse, por mirëmbajtja është ende e nevojshme. Jashtëqitjet e zogjve dhe kushtet mjedisore si hija nga ndërtesat e reja ose dëmtimi i paneleve mund të ndikojnë në performancë”, tha ai.

Hulumtuesit instalojnë sensorë të disponueshëm komercialisht për të matur prodhimin e energjisë elektrike, rrezet e diellit, erën dhe temperaturën.

Të dhënat u futën në softuer monitorimi të aftë për të parashikuar se kur ka të ngjarë të nevojitet mirëmbajtja, duke lejuar planifikimin e riparimeve përpara se defektet të shkaktojnë humbje të konsiderueshme në performancë. Gjatë rrugës, ekipi ndërtoi ekspertizë të vlefshme që tani mund të zbatohet në kërkimet e ardhshme.

“Teknikisht, këto sisteme po testohen në kushte shumë të vështira në Maltë”, tha Azzopardi. “Nëse mbijetojnë këtu, duhet të mbijetojnë kudo në Evropë.”

Mprehja e aftësive

Laboratorët e Gjallë u bënë edhe më të vlefshëm pasi të dhënat e tyre filluan të ushqeheshin drejtpërdrejt në shkollat e trajnimit, duke u dhënë studentëve përvojë praktike me instalime të vërteta diellore.

Pjesëmarrësit vizituan vendet dhe punuan së bashku me studiuesit, duke përdorur teknika të avancuara diagnostikuese si testimi i elektrolumineshencës, ku energjia elektrike kthehet në një panel diellor, duke bërë që qelizat të lëshojnë dritë të zbehtë infra të kuqe të padukshme për syrin e njeriut.

Kamerat e specializuara zbulojnë më pas çarje të vogla dhe defekte të fshehura që përndryshe do të mbeteshin të pazbuluara. Studentët gjithashtu zhvilluan aftësi praktike inspektimi, duke mësuar se si të vlerësojnë panelet vizualisht dhe të dokumentojnë defektet duke përdorur fotografi dhe lista kontrolli të strukturuar inspektimi, një proces i drejtpërdrejtë që ende mund të identifikojë një numër të habitshëm problemesh.

Mësimi duke luajtur

Megjithatë, mësimdhënia e këtyre aftësive të ndryshme në mënyrë efektive nuk është detyrë e thjeshtë, tha Melodie de l'Epine, e cila drejton aktivitetet kërkimore dhe inovative në Institutin Becquerel në Francë - një qendër kërkimore dhe konsulence e specializuar në fotovoltaike dhe një anëtare kyçe e ekipit PROMISE.

“Operimet dhe mirëmbajtja për fotovoltaike janë një temë e sfidës. Sigurimi i mjaftueshëm i njerëzve me aftësi për të instaluar, monitoruar dhe mirëmbajtur sistemet diellore do të jetë po aq i rëndësishëm nëse Evropa do të shfrytëzojë sa më shumë investimet e saj në rritje në energjinë e rinovueshme.

“Ne kemi nevojë për një fuqi punëtore të fortë dhe të trajnuar mirë që di si të kryejë mirëmbajtjen dhe të sigurojë jetëgjatësi më të madhe të sistemit”, - tha de l'Epine. “Kjo kërkon shumë trajnim, por edhe që pronarët individualë të kuptojnë se mirëmbajtja është diçka në të cilën duhet të investojnë”.

Hulumtimi ka treguar se përmirësimi i energjisë diellore është shumë më tepër sesa instalimi i paneleve të reja. Për Maltën, një nga vendet më me diell të Evropës, kushtet e vështira janë bërë një avantazh i papritur.

Duke testuar teknologjitë në disa nga mjediset më të kërkuara të Evropës, studiuesit po ndihmojnë në zhvillimin e zgjidhjeve që mund t'i mbajnë panelet diellore në funksionim të besueshëm në të gjithë kontinentin për vitet që vijnë.

Hulumtimi në këtë artikull u financua nga Programi Horizon i BE-së. Pikëpamjet e të intervistuarve nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Komisionit Evropian.

Trajnimi i riparuesve

Zhvillimi i teknologjisë më të zgjuar është vetëm një pjesë e sfidës. Sigurimi i mjaftueshëm i njerëzve me aftësi për të instaluar, monitoruar dhe mirëmbajtur sistemet diellore do të jetë po aq i rëndësishëm nëse Evropa do të shfrytëzojë sa më shumë investimet e saj në rritje në energjinë e rinovueshme.

“Ne kemi nevojë për një fuqi punëtore të fortë dhe të trajnuar mirë që di si të kryejë mirëmbajtjen dhe të sigurojë jetëgjatësi më të madhe të sistemit”, - tha de l'Epine. “Kjo kërkon shumë trajnim, por edhe që pronarët individualë të kuptojnë se mirëmbajtja është diçka në të cilën duhet të investojnë”.

Hulumtimi ka treguar se përmirësimi i energjisë diellore është shumë më tepër sesa instalimi i paneleve të reja. Për Maltën, një nga vendet më me diell të Evropës, kushtet e vështira janë bërë një avantazh i papritur.

Duke testuar teknologjitë në disa nga mjediset më të kërkuara të Evropës, studiuesit po ndihmojnë në zhvillimin e zgjidhjeve që mund t'i mbajnë panelet diellore në funksionim të besueshëm në të gjithë kontinentin për vitet që vijnë.

Hulumtimi në këtë artikull u financua nga Programi Horizon i BE-së. Pikëpamjet e të intervistuarve nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Komisionit Evropian.

Teknologjia ushtarake e së ardhmes, përtej kufijve të imagjinatës

Hapësira si fushëbetejë

Në shekujt e kaluar, kontrolli i deteve dhe i rrugëve tregtare përcaktonte fuqinë e kombeve. Sot, gjithnjë e më shumë po diskutohet se hapësira do të bëhet fushëbeteja e re. Satelitët nuk do të jenë më thjesht mjete komunikimi, por mund të shndërrohen në armë orbitale, të afta të neutralizojnë pajisjet e kundërshtarit ose të dërgojnë rreze energjie drejt Tokës. Një konflikt në hapësirë nuk do të kufizohet vetëm tek ushtritë, por do të prekte edhe jetën civile: interneti, navigimi, komunikimi global varen nga satelitët. Militarizimi i orbitës do të sillte një epokë ku kontrolli i hapësirës do të ishte po aq vendimtar sa kontrolli i oqeanëve dikur.

Armët energjetike dhe teknologjitë e reja të sulmit

Një tjetër drejtim i së ardhmes janë armët energjetike. Lazerët me fuqi të lartë, rrezet me mikrogjatësi dhe sistemet elektromagnetike po konceptohen si alternativa ndaj municioneve tradicionale. Avantazhi i tyre është se nuk varen nga furnizimi me plumba apo raketa, por nga energjia elektrike. Një sistem lazer mund të shkatërrojë raketa balistike në ajër, të neutralizojë avionë pa pilot ose të paralizojë pajisje elektronike në sekonda. Nëse këto teknologji arrijnë maturinë e plotë, ato do të ndryshojnë rrënjësisht ekuilibrin e fuqisë, duke e bërë mbrojtjen më të sofistikuar dhe sulmin më të menjëhershëm. Për më tepër, përdorimi i energjisë si armë ngre pyetje të reja mbi sigurinë e infrastrukturës civile, pasi një rreze elektromagnetike mund të shkatërrojë rrjetet elektrike të një qyteti pa asnjë shpërthim fizik.

Bio-teknologjia dhe ushtari i së ardhmes

Një tjetër horizont është përmirësimi biologjik i ushtarit. Përmes gjenetikës, nanoteknologjisë dhe implanteve biomjekësore, mund të krijohen trupa më rezistentë ndaj lodhjes, sëmundjeve apo kushteve ekstreme. Ekzoskeletet robotike, të kombinuara me materiale të lehta dhe të forta, mund t'i japin ushtarit fuqi fizike të shumëfishuar dhe aftësi për të mbajtur ngarkesa të rënda pa lodhje. Kjo nuk është thjesht fantashkencë; laboratorë të shumtë po eksperimentojnë me pajisje të tilla. Nëse këto zhvillime realizohen, ushtari i së ardhmes nuk do të jetë thjesht një njeri i trajnuar, por një kombinim i biologjisë me teknologjinë, një trup i përforcuar që sfidon kufijtë natyrorë të njeriut.

Teknologjitë kuantike

Një tjetër revolucion pritet nga teknologjia kuantike. Kompjuterët kuantikë mund të thyejnë çdo kod të sigurisë aktuale, duke e bërë kriptografinë tradicionale të pavlefshme. Po ashtu, sensorët kuantikë mund të zbulojnë lëvizje të fshehta nën ujë ose në ajër, duke e bërë të pamundur fshehjen e flotave apo avionëve. Nëse këto zhvillime realizohen, ato do të sjellin një epokë të re transparence totale në fushëbetejë. Imagjinoni një sistem që mund të parashikojë çdo lëvizje të kundërshtarit në kohë reale, duke e bërë strategjinë klasike të fshehjes dhe surprizës të pavlefshme. Teknologjia kuantike do të ndryshonte jo vetëm luftën, por edhe diplomacinë, pasi kontrolli mbi informacionin do të ishte absolut.

Materialet e avancuara

Materialet e së ardhmes – si grafeni, aliazhat inteligjentë dhe substancat vetë-riparuese – mund të ndryshojnë mënyrën se si ndërtohen mjetet ushtarake. Një tank i bërë nga materiale vetë-riparuese mund të rikuperojë dëmtimet në kohë reale, ndërsa avionët e ndërtuar me grafen do të ishin më të lehtë, më të shpejtë dhe më rezistentë. Kjo do të sillte një gjeneratë të re pajisjesh që nuk konsumohen lehtë dhe kanë jetëgjatësi shumë më të madhe. Për më tepër, materialet inteligjente mund të përshtaten me mjedisin: një uniformë që ndryshon ngjyrë për t'u kamufluar, një mburojë që forcohet automatikisht kur goditet, apo një strukturë që riparon vetveten pas një sulmi. Këto ide, sot ende në laboratorë, mund të bëhen realitet në dekadat e ardhshme.

Etika dhe dilemat e reja

Me gjithë këto zhvillime, dilemat etike bëhen edhe më të ndërlikuara. Nëse ushtari i së ardhmes është biologjikisht i përmirësuar, a mbetet ai ende njeri apo shndërrohet në një krijesë hibride? Nëse armët energjetike mund të paralizojnë qytete pa gjakderdhje, a do të konsiderohen ato më humane



apo më të rrezikshme? Nëse hapësira militarizohet, a do të humbasim mundësinë për ta përdorur atë si një mjedis bashkëpunimi ndërkombëtar? Pyetjet janë të shumta dhe përgjigjet nuk janë të thjeshta. Teknologjia e së ardhmes nuk është vetëm çështje inovacioni, por edhe çështje morali dhe përgjegjësie globale.

Teknologjia ushtarake e së ardhmes nuk është e kufizuar tek dronët apo inteligjenca artificiale, të cilat tashmë janë pjesë e realitetit. Ajo shtrihet në hapësirë, në laboratorët e

bioteknologjisë, në fushën e kuantikës dhe në materialet e reja që ende nuk kanë hyrë në përdorim masiv. Sfidat më të madhe nuk është vetëm zhvillimi i këtyre teknologjive, por mënyra se si do të përdoren: për mbrojtje dhe stabilitet, apo për dominim dhe shkatërrim. Historia na ka mësuar se çdo shpikje ushtarake ka pasoja të gjera, dhe e ardhmja nuk do të jetë ndryshe. Në fund të fundit, teknologjia është vetëm një mjet; mënyra se si e përdorim është ajo që përcakton të ardhmen tonë.



FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

*Rikthim në shërbimin aktiv
për ushtarakët në rezervë*



Qendra e Personel-Rekrutimit njofton: Ka filluar regjistrimi i kandidatëve për rikthim në shërbimin aktiv të ushtarakëve në rezervë.

Afati për dorëzimin e dokumentacionit: **Deri më 10 gusht 2026**

Për vitin 2026 janë miratuar gjithsej 30 kuota, të ndara sipas kategorive dhe specialiteteve si më poshtë:

OFICERË – 4 kuota

Forca Ajrore

Specialiteti: Pilot

- **4 oficerë**
- Gradat: **OF1 – OF3**

NËNOFICERË – 26 kuota

Forca Ajrore

Teknik Aviacioni / Helikopteri

- **4 kuota**
- Gradat: **OR6 – OR8**

Forca Tokësore dhe Komanda Mbështetëse

Teknik / Mekanik

- **5 kuota**
- Gradat: **OR4 – OR8**

Motorist

- **5 kuota**
- Gradat: **OR4 – OR7**
- Shërbimi në: Forcën Tokësore. Forcën Detare.

Komandën Mbështetëse

Shofer i mjeteve të rënda / speciale

- **6 kuota**
- Gradat: **OR4 – OR8**

Manovrator / Fadromist

- **6 kuota**
- Gradat: **OR4 – OR8**

Mos humb mundësinë për t'u rikthyer në radhët e Forcave të Armatosura!

Nëse je ushtarak në rezervë dhe plotëson kriteret ligjore, aplikoj brenda afatit dhe bëhu sërish pjesë e misionit në shërbim të vendit.

Afati i fundit për aplikim

10 GUSHT 2026

FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Qendra e Personel-Rekrutimit

Shërbe me profesionalizëm. Rikthehu në uniformë.

Për më shumë informacion:

<https://www.mod.gov.al/newsroom/njoftime/njoftime-rikthim-ne-sherbimin-aktiv>